



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Mars 2009 • Viti XXVI • Nr. 3 (173) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



JAVA E MADHE DHE KREMTIMI LITURGJIK I SAJ

FAQE 10-11

Shkruan:
DON AGIM QERKINI



**“PA DHE BESOI”
GJURMËVE BIBLIKE NË
TAKIM ME KRISHTIN
E RINGJALLUR**

FAQE 8-9

Shkruan:
DON FATMIR KOLIQI



**ZËRI I MISIONIT,
ZË I ARSYES**

FAQE 6

Shkruan:
LEKË PREÇI



Porosia e ipeshkvit për Pashkët 2009

Meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve, besimtarëve katolikë si dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë

Të dashur vëllezër dhe motra,

Pas një periudhe të gjatë katërdhjetëditore të kohës së Kreshmëve, në të cilën na u dha mundësia, që, përmes lutjes, agjërimit dhe bamirësisë, të përgatisim jetën tonë shpirtërore për takimin me të Ringjallurin, tani në festën e madhe të Pashkëve dëshiroj të bëhem jehonë e atij zëri të gëzimit dhe të shpresës, i cili na thotë: “Ju mos u trembni! E di se kërkonti Jezusin e kryqëzuar! Ai nuk është këtu! U ngjall sikurse tha! Ejani e shikoni vendin ku qe vënë” (Mt 28, 5-6).

Festa e Pashkëve është fitorja e jetës mbi vdekjen, është festa e ngadhënjimit dhe e shpresës, është premtimi i një atdheu dhe i një të ardhme që tejkalon pragun e vdekjes dhe të dëshpërimit.

Shpresa pashkëvore është kujtim i një fakti historik dhe aktual, që nuk është dëgjuar asnjëherë më parë: Krishti i kryqëzuar është ringjallur! Dëshmi e kësaj të vërtetë historike është fjalë e Zotit, e cila e përshkruan ngjarjen e grave të përshpirtshme të Jerusalemit me engjëllin e Zotit që e rrokullisi gurin e dhembjes, gurin e dyshimit, gurin e mbylljes, gurin e vdekjes... për t’iu dëshmuar atyre risinë e shpresës dhe jetës që fshihej mbrapa ati guri.

“Në të zbardhur të dritës - të ditës së parë të javës, shkuan Maria Magdalenë dhe Maria tjetër për të parë varrin. Dhe ja, ra një tërmet i madh, sepse engjëlli i Zotit zbriti nga qielli, u afrua, rrokullisi gurin dhe u ul mbi të. Fytyra e tij ishte porsi vetëtimja e petku i tij i bardhë porsi bora. Rojtarët, prej frikës së tij, u dridhen dhe u bënë si të ishin të vdekur. Atëherë engjëlli u tha grave: “Ju mos u trembni! E di se kërkonti Jezusin e kryqëzuar! Ai nuk është këtu! U ngjall sikurse tha! Ejani e shikoni vendin ku qe vënë”. (Mt 28, 1-6).

Kjo është ngjarja që e krenojmë dhe, në një mënyrë ose tjetër, e bëjmë aktuale në këtë festë të madhe të Pashkëve. Pashkët janë kremtim që i solli botës shpresën e jetës së re me Zotin dhe me të afërmin, dhe të lumturisë – pavdekësisë, si e vërtetë boshë e jetës së krishterë.

“Qoftë bekuar Hyji, Ati i Zotit tonë Jezu Krishtit, i cili na rilindi me anë të mëshirës së vet të madhe në sajë të ngjalljes prej të vdekurish të Jezu Krishtit, për shpresën jetësore, për trashëgim të pashkatërrueshëm, të panjollë e të pavyskshëm që e ruajt për ju në qiell” (1 Pjt 1, 3-4).

Ky tekst i Shën Pjetrit konfirmon që themeli i shpresës së krishterë nuk qëndron vetëm në angazhimin apo në vullnetin e mirë të njeriut për të arritur një të ardhme më të mirë, por, para se gjithash, qëndron te fakti që Zoti ka bërë për njeriun përmes Jezu Krishtit, duke e ringjallur atë nga të vdekurit. Ringjallja e Jezu Krishtit bëhet shpresë-dhënësore për fatin e mbarë njerëzimit, për të gjithë ata që mbështeten në fuqinë e mëshirshme të Zotit: të të vuajturve, të të dobëtëve, të të nëpërkëmburve, të të përjashtuarve, të të pafatëve, të të sëmurëve, të të burgosurve, të të vdekurve... u hapet perspektiva e përjetësisë.

Ky është Lajmi i Gëzueshëm i fesë së krishterë, që, në krahasim me besimet tjera, nuk mbështetet aq në një koncept të ndryshëm të jetës, apo në një doktrinë të shpikur nga dikush. Feja e krishterë mbështetet në ngjarjen historikisht, të ndodhur, në personin e Jezu Krishtit që ka jetuar, ka vdekur dhe është ringjallur për shëlbimin e mbarë njerëzimit.

Kjo bindje, që gjithmonë e ka përcjell krishterimin, është e lidhur ngushtë me dimensionin historik dhe me atë biblik; që ka ndodhur me ngjarje dhe me fjalë, të cilat janë ngushtë të ndërlidhura mes vete.

Liturgjia dhe porosia e festës së Pashkëve na fton, që, besimi apo feja në Krishtin e Ringjallur, nuk duhet të lindë vetëm nga pamja e varrit të zbrazur, nga rrokullisja e gurit apo nga frika dhe dridhja e rojtarëve. Por, që të kemi mundësi të besojmë në Ringjalljen e Tij, duhet të pranojmë nga i Ringjalluri dhuratën e fesë, të besojmë në mundimin e dashurisë së Tij, të dëgjojmë Fjalën e Tij, t’i bindemi pranisë së Tij në mesin tonë.



Ese: Eutanazia e panënshtuar

FAQE 15

Shkruan:
Pal CANAJ

Intervistë me nënën Zoje Thaqi nga Trepetica

Një jetë me peripeci, por edhe me fe dhe shpresë në Zotin

FAQE 12-13



(vijuar nga ballina)

Vetëm feja në Fjalën e gjallë dhe gjallëuese të Ringjallurit, na lejon dhe na ndihmon të vazhdojmë apo të fillojmë të besojmë në ringjalljen e korpit. Pikërisht tani, kur jetojmë në një botë të mbushur përplot me shenja të vdekjes dhe të humbjes së shpresës, kërkohet të ndalemi para kësaj fjale që na thotë: *"Ju mos u trembni"*.

Problemet që po i përjeton bota mbarë, e, së bashku me të, edhe vendi ynë: papunësia e madhe, kriza financiare, shtyrjet familjare, depresioni te të rinjtë, vrasjet dhe vetëvrasjet, vetmia e të moshuarve, krimi ndaj jetës së pafajshme, sfida e edukimit... shprehin qartas se kemi nevojë për ndihmë e Krishtit të Ringjallur për të kuptuar si duhet të dalim nga një situatë dëshpëruese.

Ringjalla e Krishtit na flet për një dashuri të përjetshme, e cila e tejkalon vdekjen dhe e përqafon jetën. Përballë kësaj porosit, ne të krishterët duhet të kuptojmë se është koha t'i hapemi risisë së dashurisë së Zotit, e cila është shpresëdhënëse edhe në ato momente, kur duket se çdo gjë ka marrë fund. Njëkohësisht duhet të jemi të gatshëm të bëhemi dëshmitarë të dashurisë së të Ringjallurit që na do dhe na dhuron jetën në vazhdimësi.

Falë fuqisë dhe dashurisë së Zotit, shpresa në Krishtin e Ringjallur na lejon të besojmë se çdo kryq dhe çdo vdekje ka në vetë një farëz jete. Këtu edhe qëndron fuqia dhe bukuria e jetës së krishterë, e cila e rikthen dëshpërimin në shpresë, mosbesimin në besim, vdekjen në jetë...

Festa e Pashkëve na fton të mos i frikësohemi 'udhës së kryqit' që njeriu mund ta përjetojë gjatë rrugëtimit në këtë botë. Na fton që mos të ndalemi në 'udhën e kryqit', mos të ndalemi në vdekje, mos të na frikësojë heshtja e varrit e as guri i madh, me të cilin është i mbuluar ai. Për Zotin asgjë nuk është e pamundur. Pikërisht për këtë arsye Krishti i Ringjallur na fton ta tresim dëshpërimin, hidhërimin dhe frikën që qëndron brenda nesh e ta mishërojmë njëriun e ri, me shpresën e ringjalljes që na dhuron besimin, gëzimin dhe jetën e pasosur.

Fjala e engjëjllit të Zotit, e cila iu drejtua grave, në një mënyrë, sot na drejtohet edhe ne dhe na thotë: *"Krishti i Ringjallur ju paraprinë në Galile"*. Kjo fjale fton të dalim nga Jerusalemi dhe të shkojmë në Galile për ta takuar Jezu Krishtin e Ringjallur.

Jerusalemi është simboli i botës së vjetër, nga e cila duhet dalë, është qyteti i Herodit, i Pilatit, i farisenjve, i turmës së madhe të popullit që preferon Barnabën më parë se Jezusin. Nga ky qytet u dëbua Jezusi përjashta dhe u dërgua në Kalvar për t'u kryqëzuar.

Edhe sot e kësaj dite jetojmë në një botë që i përngjan Jerusalemit, në një botë të mbushur me

Herodë, me Pilatë, me farisenj, me turma të mëdha njerëzish që e preferojnë më parë të keqen se sa të mirën. Jetojmë në një botë, e cila i frikësohet pranisë së Zotit, në një botë nga, e cila janë dëbuar e mira, e drejta dhe e vërteta.

Mënyra e të jetuarit dhe kriza e madhe që ka përfshirë botën e pasur, po ashtu edhe atë të varfër, dëshmon qartë, se është dëbuar Zoti nga familja, nga jeta publike, nga zhvillimet e mëdha shkencore dhe teknologjike, nga sistemi i udhëheqjes ekonomike... e, si rrjedhojë e kësaj, bota po gjendet përballë një zbrazëties dhe një frike të madhe që mund të na sjellë buzë dëshpërimit dhe, madje, edhe të humbja e madhe. Krishti i Ringjallur na fton të dalim nga kjo botë e errët, të dalim nga ky sistem jete, të ndërrojmë mënyrën e të menduarit dhe të të vepruarit, të fusim etikë dhe moral në çdo mendim dhe veprim e kështu do t'ia rikthejmë shpresën, gëzimin, harmoninë dhe dashurinë, së pari vetvetes, mandej familjes dhe mbarë shoqërisë.

Krishti i Ringjallur është hierarkia e vlerave të vërteta, të cilat pa frikë duhet t'ia ofrojmë vetvetes dhe shoqërisë. Ai është ylli polar, i cili na mëson t'ia japim drejtimin e mirë jetës sonë. Krishti i Ringjallur është garancia më e mirë dhe më e besueshme për ndërtimin e një qytetërimi më të mirë, më të drejtë, më solidar dhe më human.

Të dashur besimtarë, festa e Pashkëve dhe dëshmia e grave dhe burrave të Jerusalemit, të cilët e takuan të Ringjallurin, na fton që edhe ne, sipas shembullit të tyre, të bëhemi dëshmitarë e Krishtit të Ringjallur, të kalojmë nëpër rrugët e botës dhe pa frikë ta dëshmojmë jetën e re, të inauguruar me ngadhënjimin e jetës mbi vdekjen.

Edhe ne, të dashur besimtarë, jemi të ftuar dhe të dërguar nga vetë i Ringjalluri ta bëjmë atë që e kanë bërë të krishterët e parë dhe martirët tanë: ta shpallim Lajmin e Gëzueshëm, të dëshmojmë dhe t'i mësojmë vlerat dhe ideat e krishtera, të mbjellim shpresën e jetës, të përhapim bamirësinë dhe dashurinë e krishterë, të dhurojmë faljen dhe pajtimin, të jetojmë në harmoni me Zotin dhe me njëri tjetrin, të qëndrojmë të rrënjësor në Krishtin, të tregojmë me vendosmëri identitetin dhe personalitetin tonë.

Në fund, ua uroj festën e Pashkëve besimtarëve katolikë dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë, duke e lutur Krishtin e Ringjallur të na bëhet dritë dhe këndellje në çdo moment të jetës sonë, ta zgjojë fenë, ta përforcojë shpresën dhe ta shtojë dashurinë në zemër e secilit njeri!

PËR SHUMË MOT
PASHKËT!

Mons. Dodë Gjergji,
ipeshkëv i Kosovës

Në Doblbare u mbajt takimi shpirtërorë i meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve

"Vetmia" jo si ankesë, por si nevojë..."

"Oh, sa punë e mirë e gjë e bukur është kur vëllezërit jetojnë së bashku: si vaji ai më i miri në kokë, që zbret në mjekër, në mjekrën e Aronit, që zbret kindeve të petkave të tija, porsì vesa në Hermon, që bie në malet e Sionit. Sepse atje Zoti e jep bekimin, jetën e amshueshme" (Psalmi 133).

Filllova këtë shkrim pikërisht me psalmin 133, që është një këngë shtegtimi i atribuar Davidit mbret. Është një psalm që përshkruan bukurinë e jetës vëllazërore. Kjo bukuria jetës vëllazërore është parë dukshëm edhe në takimin e fundit që u mbajt në Doblbare me datën 7 mars 2009. Takimi kishte karakter shpirtëror dhe hynë në radhën e atyre takimeve që kanë të bëjnë me iniciativat e vitit të shën Palit. Por ky ta-

predikuesi nuk mungoi më këshilla dhe propozime për jetën konkrete duke iu përshtatë edhe rrethanave në të cilat jetojnë dhe shërbejnë meshtarët, rregulltarët dhe rregulltare e kishës sonë. Pas ligjëratës, që ishte shumë frymëzuese dhe u prit me një duartrokkitje nga dëgjuesit, erdhi edhe koha e medimit personal dhe mundësia e rrëfimit. Ishte vërtet një atmosferë e mirë ku të gjithë reflektonin dhe thello-

me shembujt e shenjtëve të mëdhenj si shën Pali, shën Frani i Asizit dhe e lumtura Nënë Tereza të cilët vërtet e jetuan intensivisht jetën dhe thirrjen e tyre më lund, agjërime dhe lëmoshë. Ai në fund i ftoi të gjithë meshtarët, rregulltarët dhe rregulltare që ti kenë gjithmonë parasysh këto figura shembullore dhe kështu të shkohet pas gjurmëve të tyre dhe të arrihet përsosmëria e amshuar. Përfjetimi ishte i madh, i të gjithëve, i këtij takimi shpirtërorë. Këtë e mundësonte edhe koha e përshtatshme që na solli Zoti si dhuratë. Pas meshës shenjte erdhi momenti tjetër shumë vëllazëror: dreka e përbashkët, të cilën me shumë bujari dhe zemërgjerësi e ofroi familja e "Shën Mhillit", në krye me famullitarin don Kolë Thaqi. Këtu vërtet të gjithë i mahnit bujaria e dhe zemërgjerësia e tij. Dhe në fund të drekës don Kola fa-



Don Franë Kola gjatë predikimit

kim ishte enkas të themi edhe për një fillim sa më të mirë të kohës se kreshmëve. Ky takim ishte për të gjithë meshtarët, rregulltarët dhe rregulltare e administraturës apostolike të Prizrenit.

Rreth orës 10:00 po thuajse gati të gjithë meshtarët, rregulltarët dhe rregulltare e kishës sonë lokale arritën dhe u bashkuan në Kishën e "Shën Mhillit" ku më një zemër të madhe bujare i prit famullitari i kësaj familje don Kolë Thaqi. Menjëherë pas bashkimit në strukturat e bukura të kësaj familje u mbajt takimi ku u paraqit më një meditim don Aleksandër Kola, famullitar në famullinë e Stubllës. Tema e takimit ishte "vetmia". Sikur theksoi edhe vet predikuesi "vetmia" jo si ankesë dhe si gjendje e pa dëshirueshme, por vetmia si një nevojë për secilin për t'u rritur dhe përforcuar në raport me Atin. Don Aleksandri në mënyrën të thjeshtë por shumë të thellë na paraqiti edhe disa përshkrime biblike që flasin për gjendjen e vetmisë dhe të nevojës se saj. Sidomos solli shembullin e Jezu Krishtit, i cili shpesh herë tërhiqej në vetmi për t'u lutur Atit të tij. Pastaj



Gjatë medimitit në Doblbare

heshin në brendinë e tyre duke pasuruar jetën e tyre shpirtërore. Në ora 11:30 të gjithë u bashkuan për të lutur rruzaren shenjte dhe më pastaj për të vazhduar në ora 12 me momentin me kulmor që është Eukaristia. Pra meshën shenjte e udhëhoqi don Franë Kola, famullitari i Velezhës dhe njëherësh delegat i përgjithshëm. Don Frana në fjalën e rastit u drejtua të pranishmëve duke ju kujtuar atyre rëndësinë e madhe të kësaj kohës kreshmore, si kohë e volitshme për kthimin tonë dhe të tjerëve kah rruga e vërtet që është Zoti. Ai foli për simbolin e ujit-pagëzimit me të cilin besimtarët janë të rilindur dhe duke lidhur pastaj me shembullin e gruas samaritane dhe

lënderoi meshtarët për zgjedhjen e kësaj familje duke ofruar me tutje edhe gatishmërinë e tij për bashkëpunime të tjera eventuale me rininë apo me fëmijët. Nuk guxojmë të harrojmë edhe kontributin e rinisë së Doblbarës në përgatitjen dhe në shërbimin gjatë kësaj dite. Edhe këta të rinj më gatishmërinë e tyre ishin shembull i mirë i angazhimit të tyre në famulli dhe falënderimi ynë ishte i madh për ta.

Me këto ndjenja të thella shpirtërore, më këtë pasuri të madhe shpirtërore, dhe me këtë afërsi vëllazërore u përfundua edhe ky takim i fillimit të kreshmëve për meshtarët dhe motrat e administraturës apostolike të Prizrenit.

(Don Jeton THAQI)

Në kujtim të Ditës së Mësuesit

Shkolla e Zymit - krenari kombëtare

Kur shfletojmë hartën e shkollave shqipe në trojet etnike shqiptare, pa dyshim se e hasim edhe në shkollën e Zymit për të cilën po të hartonim edhe një monografi të re të kësaj shkolle (përveç "Abetarja e Zymit" të Nikollë Kërhanajt, 1997) do ta titullonim "Dëshmia e të ekzistuarit". Kjo, nga fakti se është një dëshmi e gjallë se kemi jetuar e bashkëjetuar, dhe, së bashku me Zymin, kanë krijuar një botë e një histori në vete që kanë mbajtur gjallë vetëdijen kombëtare e fetare për punë dhe veprimtari edukativo-arsimorë në këtë mes.

Kjo shkollë me arsimtarët e saj kanë formuar tempullin e dijes për Has, ndaj si shkolla ashtu edhe arsimtarët meritojnë shumë falënderime e mirënjohje për punën dhe veprimtarinë edukativo-arsimorë.

Rruga e shkollës së Zymit është si një odisejadë (shqip: udhëse ose ide e udhëtimit që rrjedh nga gjuha pellazge-ilire-ardëre e shqiptare). Nga e gjithë kjo del se shkolla e Zymit është një përmendore edukativo-arsimorë, arsimtarët e të cilës kanë nga një histori në vete. Shkrimtari, po ta mësonte këtë histori, do t'ua shkruante të gjithëve nga një monografi jetësore apo poezi, me të cilat do të formohej një përmbledhje apo një antologji e fuqishme poezish, pa i llogaritur nxënësit që dolën nga ky mes, njëherësh edhe pa i llogaritur arsimtarët pas viteve 1963.

Në këtë vendbanim (Zym), i cili ka bërë emër në shumë fshoja, në atë fetare, kombëtare, shkollore e kulturore, padyshim se kanë ndikuar si vendasit, në një anë dhe në anën tjetër (ndoshta edhe më shumë) personalitetet e njohura gjithëkombëtare duke shtuar se këtu domosdo kanë kaluar e qëndruar: Gjergj Bardhi (1634-7), Bonaventura e At Kurebini (1634), Marin Bici (ndoshta më 1610), Pjetër e Gërgur Mazrreku (1651 që ishin miq me familjen Bogdani nga fshati Gjjan - Zym), Vincenc Zmajeviqi (1703), Andre, Pjetër, Gjon e Lukë Bogdani, Pal Hasi, Pjetër Karaxhiq etj.

Nga e gjithë kjo garniturë priftërinjsh (personalitete të dijes e kulturës) në Zym, më i merituari do të mbetet Gjon Nikollë Kazazi në cilësinë e kryepeshkvit, me seli-strehimi në Zym, që zbuloi "Mesharin" e Buzukut, i cili në vitin 1747 raporton në "Kongregatën për Përhapjen e Fesë" (De Propaganda Fide) në Vatikan në Romë se në banesën e tij, si në Gjakovë ashtu edhe në Zym, është duke i përgatitur 7 (shtatë) djelmosha për të vijuar Akademinë e Teologjisë, përkatësisht për seminarin-



konviktor në Itali. Duke raportuar më tutje, se, rezultati i punës së tij ishte se vet Gjon Nikollë Kazazi, përveç se e kishte përgatitur kandidatin Josip (Zef) Lumezin, ai edhe e kishte dërguar personalisht në studime në vitin 1740 (atëherë ishte në shtëpinë e vet në Gjakovë), por edhe pas ardhjes në Zym, nga dora dhe përgatitja e tij e kryen teologjinë edhe don Anton Lumezi e të tjerë. Megjithatë, edhe para ardhjes së tij, teologjinë e kishin kryer dy kandidatë: Don Pjetër Bytyci (1688-1756 (?) dhe Don Andej (është quajtur edhe Ndrej, por edhe në familje njihet me emrin Ndue) Lumezi (1711-1733 - nga ky vit nuk përmendet më, për të cilin nga goja e popullit tregohet një gojëdhënë - baladeske... (?), të cilët u parapërgatitën për shkrim-lexim në Zym. Ka edhe të tjerë, emrat e të cilëve nuk po i shënojmë.

Pas raportit të parë të vitit 1747 do të radhisim faktin i dytë për shkollën shqipe në Zym sipas raportit, dërguar në Romë në "Cronica Delle Missioni Albanese-1864", fq. 107-110, ku thuhet se në Zym organizohej një shkollë në gjuhën shqipe në të cilën merren njohuri të përgjithshme si dhe mësimi fetar-lutje në gjuhën latine-italiane me frëtitë-mësues: Patër Emilio da Cles (Patër Mila), Patër Ludovico Taggiasco dal Sasso, Patër Emilio da Carpineto, Patër Emiliano Cluis, Patër Duriv Orciv, më vonë Patër Ndue Mjetti, shqiptar nga Sapa. Të shtojmë se Patër Mila i njihje 6-7 gjuhë botërore edhe gjuhën shqipe sepse kishte punuar shumë vite në trojet shqiptare prandaj edhe kishte autoritet ndër shqiptarë.

Po ashtu, si një organizim i tretë, dihet mire fakti se prej vitit 1880 në Zym ka punuar e vepruar shkolla në gjuhën shqipe, mësimin e së cilës e kanë mbajtur - udhëhequr priftërinjtë françeskanë, që kishin rreth 50 nxënës. Ata kishin përdorur alfabetin e vjetër të Stambollit. Ishte shkollë kryesisht për meshkuj dhe mbahej në konakët e kishës (sipas dr. Jashar Rexhepagiqit: "Shkollat

dhe arsimit në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjër më 1912", fq. 190. Mësimin e kanë mbajtur: Patër Pjetër Battista prej Verolle (Italian), Patër Pjetri i Ri (Battista) - Pecollaj, ishte zymjan, Patër Tom Ivanaj, Patër Serafin Kucari, Patër Pashk Dukagjini, Patër Pjetër Zarishti etj.

Në vazhdim, sipas shënimeve dhe hartave historike të shkollave shqipe, si: "Rritja e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1882-1908", nga viti 1899 deri në vitin 1912, në shkollën e Zymit kanë mësuar shkrim-lexim mbi 30 nxënës. Shkolla ishte një ent dhe veprë unike me frymë humaniste e periudhës së Rilindjes Kombëtare në gjuhë shqipe, e cila u bashkua një lëvizjeje gjithëkombëtare për të kultivuar dashurinë për fe e atdhe, për t'iu bashkuar të gjitha qendrave të mëdha për një shkollë unike kombëtare.

Nga viti 1900, kur në Zym u botua "Abetarja e Zymit" (20 maj 1900), deri më 1912, mësimin e mbanin priftërinjtë françeskanë: Shtjefën Krasniqi, Pjetër Battista, zymjani, Fran Kiliqi, Pashk Prela e Gjon Blushaj. Në vazhdim, në vitin 1912/1913/14, mësimin e mbajti mësuesi Franë Gaspër Lufi nga Shkodra (1888-1939), në vitet 1915/1917 mësues ishte Pal Gaspër Lumezi (1890-1944), i quajtur Pal-shkollari (nga Zymi, i dalur në Prizren), Franë Hilë Pecolli, zymjan, ndërkaq, ndërmjet viteve 1917/20 ishte emëruar dhe punoi Ndue (Nokë) Tupeci (1901-1976), ndërsa drejtor i shkollës ishte Patër Marjan Prëla (1887-1976). Mësimi deri në vitin 1912 mbahej në konakët e kishës. Nga viti 1912 deri në vitin 1916 mësimi mbahej në shtëpitë e Tomë Lukë Lumezit, pastaj në shtëpinë e Ivan Doçit, Nikë Hilë Koldoçit, Gegë Nokë Prekpalajt e në ndonjë tjetër. Në këtë periudhë, kur Zymi kryesisht ishte zonë neutrale, mësimin e kanë vijuar edhe femrat e të dy konfesioneve (katolike e myslimane, rreth 40-sish) por në shtëpia-shkollë të veçanta sipas gjinisë së nxënësve. Prej vitit 1916 deri në vitin 1920 mësimi u mbajt në lokale të veçanta që u ndërtua për

Rendin e Tretë të françeskanëve në oborrin e kishës.

Shkolla dhe veprimtaria e saj edukativo-arsimorë u zhvillua edhe nga viti 1925 deri në vitin 1939 por në gjuhën serbokroate-slllovene, ku mësimin e vijuan nxënës nga Zymi, Krajku, Lukini, Ramaja e Shëngjergji e ndonjë tjetër. Mësimi mbahej në shtëpi private, si të Ndue Kërhanit, të Frok Gegës (më heret ishte e Hilë Lazër Prekpalajt), Balë Cilës etj. Nga viti 1940/41 e këndej filloi shkolla e Mbretërisë Shqiptare me mësuesit: Nikollë Prenkë Veseli (1907-1992), Prengë Ndue Prenga, mirditas (1917-1993), Sebë Matej Rodiqi (1923-1949), Palush Pjetër Lumezi (1912-1989), Gaspër Krasniqi(?), Lucie N. Gjini - Lumezi (1931-), Fehmi Sinella (1923-) e të tjerë pas tyre, nga viti 1950 e këndej.

Gjithë këta e të tjerët pas tyre krijuan SHKA-në "Katarina Jospipi" dhe klubin letrar "Shtjefën Gjeçov", nga i cili klub doli manifestimi letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit", që organizohet nga viti 1971 dhe shkollën e mesme nga viti 1970/71. Brezat e hershme vunë durin themeltar, andaj edhe në shenjtë të kujtimit të tyre, në qendër të fshatit u ngrit lapidari "Abetarja e Zymit, 1900".

Dhe, sot, në Ditën e Mësuesit duhet t'i përkujtojmë themeluesit e shkollave, sidomos tash kur falë mësuesëve krentojmë lirinë, të cilën përherë e predikuan. Ata i morën fëmijët përdore për t'ua mësuar shkrim-leximin fillestar shqip me fjalët më të bukura e më të ëmbla, sepse dijen e konsideruan pasuri të madhe që u takon të gjithëve.

(Nikollë KËRHANAJ)

Festa e shën Jozefit – festë e dyfishtë

Më 19 mars në ditën kur Kisha Katolike kremton festën e shën Jozefit, pajtorit të Kishës dhe të familjes, në Katedralen e Zojës Ndhimëtare në Prizren ishte festë e dyfishtë.

Një vajzë e re, një motër e jona e cila më parë i përkiste besimit islam, kishte vendosur që të bëhet antare e Kishës Katolike duke pranuar sakramentin e pagëzimit. Ajo me plot dëshirë, dashuri, gëzim veprori sipas vullnësës së Zotit.


Meshën shenjte dhe sakramentin e pagëzimit e ndau don Lush Gjergji famullitar i Prizrenit në bashkëmbëshim me meshtar të tjerë.

Pranvera Rexhepi e cila kishte marrë guximin për ta shprehur hap-tas dashurinë dhe besimin në Jezu Krishtin, gjatë pagëzimit të saj në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit Shenjt ishte në emocione, por në ftyrën e saj

shihej gëzimi, lumturia dhe dashuria.

Pranvera, sikurse edhe motra e saj Vera që para një viti u pagëzua, tani më është bërë antare e Kishës Katolike dhe ne si bashkësi e themeluar në Krishtin i urojmë të gjitha të mirat dhe bekimet e Zotit.

(Elizabeta LEKAJ)



Pagëzimi i Pranverës në Katedralen e Prizrenit

Të martet e shën Antonit

Më 17 mars 2009 kanë filluar 13 të martet e shën Antonit të Padovës. Si çdo vit, në Gjakovë me atë rast është bashkuar një shumicë e madhe populli, jo vetëm nga Gjakova dhe famullitë rreth saj, por edhe prej famullive tjera, më të largëta.

Mëshën kryesore në orën 10 e kemi kremtuar në oborrin e kishës së shën Antonit. E udhëhoqi don Prekë Lazraj, drejtor i "Radio Marisë" në Shkodër, së bashku me famullitarin e Gjakovës, p. Anton Nua dhe me famullitarin e Velezhës, don Franë Kolën.



Don Prekë Lazraj gjatë predikimit në Gjakovë

Pasi jemi në vitin e Shën Palit apostull, gjatë 13 të marteve do të predikohet për jetën dhe veprat, teologjinë dhe porosinë e këtij apostulli të madh të popujve. Don Preka ka predikuar për jetën e shën Palit, duke e theksuar në mënyrë të veçantë kthimin e tij – që duhet të jetë nxitje edhe për kthimin tonë të plotë në rrugën e Zotit.

1) Prindërit e shën Palit birit të vet ia ngjiten emrin SAUL – dmth. emrin biblik, emrin e mbretit të parë të popullit izraelit. Çfarë emrash ngjesin besimtarët tanë fëmijëve të vet? Emrat e fesë dhe të kulturës së krishterë, emrat e shenjtërve, emrat biblikë, apo emrat pa kurrfarë domethënie fetare?

2) Krishti e pyet Saulin: "Saul, Saul, pse po më shkon?" – A thua ti sot nuk e salvon Jezu Krishtin, kur e vret vëllain tënd, kur hakmerresh, kur e thyen kurorën, kur e ndan kurorën e martesës, kur vjedh, kur plaçkit dhe kur bën padrejtësitë tjera kundër të afërmit tënd dhe mëkate kundër ligjit të Zotit..., pyet don Preka.



Besimtarët e pranishëm për të martet e shën Antonit

3) Pastaj Sauli e takon Ananinë, pranon fajin e vet, e nxjerr të keqen nga zemra, lirohet nga djalli, e dëshmon besimin e vet në Krishtin dhe pagëzohet. Edhe çdo besimtar i krishterë duhet të pajtohet me të afërmit e vet dhe me të madhin Zot me anë të sakramentit të rrëfimit.

4) Palit nuk i mjafton vetëm takimi me Krishtin. Ai dëshiron ta njohë sa më mirë Krishtin, fjalën e tij, mësimin e tij. Prandaj prapë e studion Shkrimin Shenjt dhe shkon në Jerusalem për t'u takuar me shën Pjetrin dhe me shën Jakobin apostull – që me

anë të Kishës dhe të Biblës ta njohë sa më mirë Krishtin Zot.

Në mbarim të meshës P. Anton Nua, famullitar dhe gvardian i Gjakovës, e falënderoi Zotin, i cili e bashkon popullin e vet, dhe don Prekën për fjalën e bukura, duke uruar besimtarëve që t'i shfrytëzojnë nxitjet e tija për shenjtërimin e vet personal... Shpalli edhe emrat e mirëbërësve për ndërtimin e kishës së shën Pjetrit e Palit.

Krejt meshën e ka transmetuar drejtpërdrejt Radio Maria Shqiptare (nga Studio e Gjakovës), të cilën shqiptarët e dëgjojnë jo vetëm në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni, por edhe anembanë botës, me anë të internetit. Don Preka premtoi se Radio Maria për 13 të marte të shën Antonit çdo të martë do të transmetojë drejtpërdrejt meshën e shenjtë: një herë nga Gjakova, e tjetër herë nga Laçi – dmth. nga dy shenjtërore kryesore të popullit shqiptar, të kushtuara shën Antonit.

(L. G.)

Kisha Katolike në Azi

■ SHKRUAN:
Simon FILIPAJ, Tivar

Në disa numra të Dritës do të paraqesim gjendjen e Kishës Katolike në kontinentin e Azisë. Do të sjellim materiale rreth gjendjes socio-politike dhe ekonomike të këtyre vendeve, por sidomos marrëdhëniet me disa prej këtyre shteteve dhe Kishës. Vëmendje të veçantë do të zërrë gjendja e Kishës në Kinë, me gjithë vështirësitë që paraqet regjimi dhe drejtimi i tij politik dhe ekzistimit të dy kishave, asaj patriotike dhe asaj të lidhur me Romën, gjegjësisht me Vatikanin. Një vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë edhe përndjekjeve ndaj kishës në Indinë lindore. Interesi ynë do të drejtohet pikërisht drejt këtyre kontinenteve, sepse të krishterët janë në një numër të vogël, pra gëzojnë gjendjen e pakicave fetare, por njëkohësisht edhe kërkojnë me ngulm kujdesin dhe vëmendjen tonë. Kështu shprehet një i krishterë i Indisë, nga zona që në muajt e fundit ka qenë shfaqje e përndjekjes sistematike dhe të pashpirt kundrejt shumë vëllezërve dhe motrave në fe: "Fitimi për ne, në mënyrë që bota të mos na harrojë!" "Faji" i tyre është se kanë gjetur të krishterim rrugën për të arritur dinjitetin e tyre dhe zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Të njëjtën gjë e thonë dhe disa katolikë të Kinës: "Faleminderit që denonconi (paditni) dhunën e regjimit kundër Kishës dhe nuk i përkuleni valës së përgjithshme, që kërkon të përkëdhelë Kinën për ndonjë përparësi ekonomike". Lista mund të jetë tepër e gjatë: ka myslimanë të kthyer, që rrezikojnë të vriten në Vendet ku është në fuqi sheriat, pra mundohen të komunikojnë dashurinë e Krishtit por njëkohësisht ekziston frika se mos shtypen nga bashkësia myslimane. Kërkojmë që të jemi edhe ne sadopak solidarë me këta të krishterë që hasin vështirësi në dëshminë e Krishtit në vendet dhe kulturat e tyre. Sigurisht për ne Azia nuk përbën vetëm një treg të stërmadh, ose si një hapësirë interesi politik, ku mund të ushtronim ndikimin tonë. Mundohemi që të perceptojmë kushtet e vështira të punëtorëve, vështirësitë e familjeve, zërin e shumë disidentëve, dëshpërimi dhe shpresa që përziehet në zemrën e të rinjve. Gjithashtu jemi kundër, dhe këtë dëshirojmë t'i japim lexuesve tanë, stereotipave katastrofike, që shohin Azinë dhe njerëzit e saj si një dështim njerëzor dhe so-

cial, për t'u mbajtur në distancë. Hedhim shikimin tonë përtej fundamentalizmave dhe kërkojmë një përvojë religjioze(fetare), në të cilën Hyji të ketë vendin e vet pranë merakosjeve të përditshme. Shpresë e madhe na vjen sidomos nga gjallëria e kishave të krishtera të Azisë, gjithnjë në rritje, të afta për kurajë dhe martirizim. Pra, bashkësi që ofrojnë një dëshmi që di të bashkërendojë dashurinë e Hyjit dhe të afërmit, dinjitetin e njeriut dhe mirëqenien e kombit, dashurinë për kulturën e vet dhe hapjen ndaj botës.

Kina Gjendja e kishës nëntokësore ose ilegale në Kinë

Përpara se të hidhemi në përshkrimin e gjendjes së Kishës në shtetin me popullsinë më të madhe të botës, duhet të themi se Kisha Katolike ndodhet në një gjendje shumë delikate për arsye se në Kinë kemi të pranishme dy Kisha të cilat veprojnë njëra në mënyrë ilegale (të fshehtë) kurse tjetra e quajtur Patriotike (ose na-

nëntokësorë kanë sfiduar kontrollin e policisë duke u mbledhë në kishën e Wuqiu(Hebei) për të kremtuar meshën Zojës së Ngritur në qiell me ipeshkvën e tyre, imzot Xhulio Jia Zhiguo, i cili ka qenë në arrest shtëpiak i kontrolluar 24 orë, dhe ka qenë e ndaluar ta takojnë seminaristët apo meshtarët e tij. Jia është ipeshkvë i dioqezës nëntokësore të Zhengding(Hebei), me më shumë se 110 mio katolikë, së paku 80 priftërinj dhe më shumë se 90 motra nderi. Bile, me rastin e Olimpiadave të gjithë besimtarët e Kishës nëntokësore ishin paralajmëruar nga policia të mos takoheshin gjatë periudhës së Lojërave për "arsye sigurie", ndërkaq prelatë dhe meshtarë pësojnë arreste shtëpiake. Por e krenmtja e Zojës së ngritur në qiell është një ndër festat më popullore në Kinë shenjtë. Për këtë arsye edhe besimtarët e kanë "thyer" ligjin për të marrë pjesë në kremtimin e meshës së shenjtë së bashku me ipeshkvën e tyre i cili u siguron edhe bashkimin me Kishën Katolike. Ipeshkvi vazhdon ende të



Brendësia e një kisha katolike në Kinë

cionale) është e lidhur me shtetin dhe kuptohet e varur prej shtetit, e cila gëzon mbështetjen e këtij të fundit në veprimin publik. Për këtë arsye duhet të na bëhen normale denominimet ilegale ose nëntokësore dhe patriotike. Kjo na ndihmon edhe të shohim se shpesh herë bashkimi me Romën nuk është gjithmonë i arrirë dhe se kjo paraqet vështirësi sidomos në kujdesin shpirtëror që i takon Vatikanit të ketë mbi besimtarët e vet dhe rregullimin e jetës së kishës. Probleme janë shfaqur në shugurimin e disa ipeshkvijve pa miratimin e Vatikanit dhe zbritja gjithnjë e më në ilegalitet e pjestarëve të kishës, e cila nuk pranon nënshkrimin ndaj vullnetit të shtetit.

Më shumë se 1000 katolikë

qëndrojnë i izoluar, dioqeza drejtohet nga meshtarët vullnetmirë të cilët mundohen të veprojnë edhe pse të vëzhguar nga policia. Imzot Jia, 73 vjeçar, ka kaluar 15 vite në burg, nga '63 deri në '78. Nga '89 ndodhet nën vëzhgim të rreptë të policisë. Këto vitet e fundit është arrestuar dhe liuar 11 herë. Vatikanin në të shkruarën ka kërkuar lirinë e tij, por kërkesat e tyre kanë rënë në vesh të shurdhët.

Është interesante se gjatë Lojërave Olimpikë në ambientet e fshatit olimpik, të huajt kanë gëzuar liri fetare të plotë (ose gati), ndërsa Kisha nëntokësore, siç thamë më sipër, janë nën mbikëqyrje të rreptë të policisë dhe të shoqatave patriotike. Në fshatin olimpik ishte krejt një zonë e kushtuar përshpirtërisë dhe lutjes.

Të krishterët katolikë dhe protestantë bashkëndanin ambiente të përbashkëta; ka pasur vende për budistë dhe myslimanë, për hebrej dhe hindusë, duke u kujdesur edhe për ushqimin që shërbehej sipas religjioneve. Turistët e huaj në përgjithësi trajtohen mirë, por ka edhe përjashtime. Një grup të krishterësh amerikanë kanë ndaluar në Kunming (Yunnan) sepse sillnin me vete 300 kopje të Biblës. Ligjet kineze e ndalojnë importimin e librave religjioz në sasi më të madhe se sa për përdorim personale. Përpjekja për të ndarë fetarë kinez nga ato të huajt bën pjesë në planin e shoqata patriotike që synojnë të ndërtojnë kishë kombëtare, e ndarë nga të gjithë. Për këtë arsye, edhe me kritikë të ndryshme kundër censurës që bën Kina kundrejt sajteve të internetit, shumë sajte katolike me disa fletë në kinezisht janë akoma të bllokuar. Ndër këta: Radio Vatikan, AsiaNews, sajti i Kishës së Hong Kongut, Koreës, Singaporit, ... çështja e "sigurisë" mbizotëron me vite tashmë skenën shoqërore kineze ku çdo ditë, për shkak të korrupsionit, shpronësimeve, ndotjes shpërthejnë nga 200 deri në 300 kryengritje, ku në vend që të luftohen dhe të eliminohen shkaqet e përplasjeve, parapëlqehet arrestimi i kryengritësve, të shtënat mbi turmën, mbytja e tubimeve. Gjatë periudhës olimpike Kina është munduar të tregohet liberale dhe moderne, dhe pikërisht për të ruajtur këtë imazh nuk i lejohet askujt që të bëjë peticione, të shpreh mendime që nuk përkojnë me besimin zyrtar. Për këtë paguajnë edhe të krishterët edhe pse kurrë nuk kanë qenë të përfshirë në revolta kundër kombit. Edhe meshtarët e Kishës zyrtare janë detyruar që gjatë kohës së Lojrave të mos bëjnë tubime publike me më shumë se 200 besimtarë. Ndodhë kështu që meshtarët të ndryshëm, nga frika se mos i mbajnë për një kohë tepër të gjatë besimtarët në kishë, parapëlqejnë që të mos kumtojnë aspak home-line, madje as të dielave. Përveç Hebeit, probleme të ngjashme ka pasur edhe Tianjin, ku priftërinjtë dhe ipeshkvijtë të Kishës nëntokësore janë në arreste shtëpiake. Besimtarëve u kërcënohen me gjoba të kripuara nëse mirëpresin ndonjë meshtarë. Kanë anuluar gjithë aktivitetet verore dhe kanë detyruar meshtarët që të ndërmarrin udhëtime për t'i shkëputur nga bashkësitë e tyre. Mbresa e shumë vëzhguesve të jashtëm është se Kina mundohet të krijojë gjithnjë e më shumë një imazh të një vendi sa më të hapur dhe liberal jashtë kufijve të saj, por në të vërtetë brenda për brenda vazhdojnë kontrollat dhe kushtëzimet. Për rritur shembëlltërinë e "parajsës" së lirisë fetare, *China Daily*, një e përditshme gjysmë-shtetërore në anglisht (më e lexuara prej turistëve) vazhdimisht mundohet të përçojë për të huajt një imazh të tillë.

Problemet fetare, për të cilët më shumë jemi duke folur du-

hen vendosur në një kuadër më të gjerë. Problemet që kisha has me shtetin kinez janë po ashtu tepër të theksuara edhe për disa pjesëtarë të popullit kinez të cilët mendojnë "ndryshe". Ia vlen të përmendet masakra në sheshin Tiananmen, që këtë vit ka 20-vjetorin, ku disa aktivistë pjesëmarrës ende janë nëpër burgje.

Papa gjatë vitit 2008 është lutur në mënyrë të veçantë për popullin kinez me rastin e festës së Zojës Sonë të Sheshanit, që njëkohësisht është dita e lutjes për Kishën në Kinë 24 maji. Benedikti XVI i ka kërkuar "Nënës së Kinës dhe të Azisë t'i mbështesë besimtarët, që kurrë të mos tremben për t'i folur për Jezusin botës dhe për botën Jezusit" dhe "të jenë gjithnjë dëshmitarë të besueshëm të kësaj dashurie, duke qëndruar të bashkuar gurit të Pjetrit". Bile, në letërn drejtuar Ipeshkvijve, meshtarëve, të kushtuarve dhe fetarëve laikë të Kishës katolike në Republikën Popullore të Kinës, të 27 majit 2007, Papa shkruan: "Të dashur barinj dhe fetarë, dita e 24 majit, që është e kushtuar kujtim liturgjik të së Lumes Virgjëres Mari, Ndihma e të krishterëve-e cila ndërohet me shumë përsëritje në shenjtëroren mariane të Sheshanit në Shanghai, në të ardhmen mund të bëhet rast për katolikët e botës mbarë të bashkohen në lutje me Kishën që është në Kinë. Dëshiroj që ajo datë të jetë për një ditë lutjeje Kishën në Kinë. Ju nxis që ta kremtoni në mënyrë që duke ripërtëritë bashkimin tuaj të jesh në Jezusin Zotin Tonë dhe besnikërisë ndaj Papës, duke u lutur që bashkimi mes jush të jetë më i thellë dhe i dukshëm...". [Në të njëjtën Ditë katolikët në gjithë botën do të tregojnë solidaritetin dhe ndihmesën për ju, duke i kërkuar Zotit të historisë dhuratën e qëndrueshmërisë në dëshmi, të sigurt se vauajtjet tuaja në të shkuarën dhe në të tashmen për Emrin e shenjtë të Jezusit dhe besnikëria e guximshme ndaj Vikarit të Tij në tokë do të shpërblehen, edhe pse shpesh herë mund të duket një dëshitim i trishtueshëm". Dëshitimi i trishtueshëm është shumë real, sidomos kjo është vënë re vitin e kaluar, ku çdo vit katolikët zyrtarë dhe nëntokësorë organizojnë shtegtime nga i gjithë vendi drejt Sheshanit, e cili është shenjtëroja mariane kombëtare.

Vitin 2008, pra u është ndaluar nga autoritetet qeverisë së Shanghai-t diqoezave që të organizojnë shtegtime në Sheshan gjatë gjithë muajit maj sa që ua kanë ndaluar edhe restoranteve dhe hotele që t'u bëjnë mikpritje shtegtarëve. Për këtë arsye, shumë diqoeza janë detyruar të bëjnë shtegtimin e tyre gjatë muajit prill. Kjo sjell shumë e rreptë e autoriteteve kineze ndaj shtegtimin mendohet se ka si qëllim që të ndalojë tubime të mëdha, por është edhe si kundër përgjigje ndaj ftesës së Papës bërë për Kinën dhe bashkimin e

Kishës së atjeshme lokale me Romën.

Por sot si janë marrëdhëniet mes Kinës dhe Selisë së Shenjtë. Ngjarja e Lojrave Olimpikë a ka ndryshuar ndonjë gjë për mirë? Me keqardhje duhet të themi: JO. Akoma edhe një herë autoritetet kineze nuk u kanë lejuar pjesëmarrjen ipeshkvijve në sinodin e tetorit të shkurt. Pastaj dhe selia ipeshkvnore e Pekinit, e zënë në dekadat e kaluara nga ipeshkvij me emërim vetëm qeverisë dhe pa miratimin e papës, por megjithatë e "ripushtuar" nga Roma dy vite më parë me vendosjen e një ipeshkvi të miraturat si nga qeveria si nga Selia e Shenjtë, rrezikon seriozisht të humbet përsëri. Partia komuniste ka shpeshuar dhe dëndësuar shtypjen për të nënshtruar Kishën dhe për të ndarë nga Roma një pjesë të mirë të saj. Këto shtypje bëhen sidomos mbi ipeshkvijtë e vendosur nga qeveria. Pjesa më e madhe prej tyre vit pas viti kanë hyrë në bashkim me

se "vënia në veprim e parimeve të pavarësisë, autonomisë, vetëregullimit dhe mbarështimit demokratik të Kishës është e papajtueshme me doktrinën e katolike". Por për të mbajtur të bashkuar ipeshkvijtë dhe për të frenuar ndikimin e Asociacionit Patriotik, sekretari i Shtetit të Vatikanit, kard. Tarcisio Bertone ka dërguar një letër të gjithë ipeshkvijve kinez, më 22 prill 2008, që janë në bashkim me Romën. Në të tërhiqet vëmendja në "parimet themelore të fesë katolike" dhe kujton vlerën e bashkimit të ipeshkvijve me papën dhe ndërmjet tyre, sidomos mes atyre zyrtarë dhe që qëndrojnë të fshehur. U ka kërkuar të gjithë prelatëve të "të shprehin detyrën e vet si barinj", duke nxitur natyrën katolike të Kishës dhe duke kërkuar të fitojnë liri më të madhe për veprimtari nga autoritet civilë nëpërmjet një dialogu të drejtëpërdrejtë dhe më të respektueshëm. Sidomos i shtynë që të gjejnë mënyra dhe të "veprojnë së bashku", duke

kërkuar që të takohen si grupe dhe të flasin me liri për problemet e tyre. Problemi bëhet gjithnjë e më urgjent, sepse janë në përgatitje takime në nivel kombëtar për të votuar kryetarin e Asociacionit Patriotik dhe kryetarin e Këshillit të ipeshkvijve kinez, një lloj konference ipeshkvnore që Selia Shenjte nuk e njeh, e që mbledh vetëm ipeshkvij zyrtarë. Këto dy poste janë bosh. Fushata e kontrollit mbi ipeshkvijtë, fakti që i shtërngojnë të marrin pjesë në disa seksione politike, kremtimet për 50 vite të shugurimeve të ipeshkvijve kinez

të ndarë nga Roma të promovuara nga Fronti i Bashkuar dhe Asociacioni Patriotik synojnë të thejnë çdo rezistencë nga ana e ipeshkvijve zyrtarë, për t'i nënshtruar strukturave tradicionale të kontrollit. Por ia vlen të përmendet për qëndrimet e tija shumë pozitive kard. Jozef Zen Zekiun, i Hong Kongut, i cili u kërkon priftërinjëve dhe ipeshkvijve zyrtarë të jenë më guximtarë dhe të mos bëjnë kompromise me regjimin. Duke ditur se kard. Jozef Zen Zekiun përderisa ka qytetarinë e Hong Kongut gëzon një status të veçantë nga ipeshkvijtë e tjerë kinez. Me gjithë këto probleme prapë se prapë jeta fetare në Kinë është aktive, sa që gjatë këtij muaji,

famullia e Shën Jozefit përgatitet për të festuar pajtorin e saj duke rinisur misionin. Kisha e së cilës i ka rrënjët që në kohën e misionarit jezuit Matteo Riccit në 1655. Për kohën e Kreshmëve 2009 ipeshkvijtë kanë botuar letrat e tyre baritore. Duke nxitur besimtarët për një kthim të vërtetë, për bamirësinë e krishterë, faljen dhe kujdesin kundrejt punëtorëve dhe emigrantëve, sidomos për të papunët. Imzot Jin, ipeshkëvi i diqoezës së Shanghai-it i inkurajon fetarët e tij të ushtrorjën dashurinë e krishterë, duke nënvizuar arsyen e kësaj veprë bamirësie, se kjo veprë nuk është për të kthyer dikë, por e gjen themelin e saj mbi faktin se "jemi të krishterë që sjellin dashurinë". Kjo është sa për t'u njohur pak me realitetin e Kishës në Kinë, dhe për problematikat që ata duhen të përballen dhe një shkak më i madh për t'i kujtuar në lutje.

Raporti për vitin 2008: "një vit i zi" për pakicat e krishtera në Indi

Viti 2008 ka qenë një vit i "tmerrshëm" për kushtet e pakicave të krishtera në Indi, të nënshtruarra dhunës pa fre dhe sulmeve pa precedentë: këtë pohon Raporti vjetor 2008 i All India Christian Council (AICC). Kanë qenë 106 sulmet e izoluar kundër personelit apo strukturave të krishtera në 2008, që kanë përfshirë 16 shtete të Bashkimit Indian, me një mesatare të 9 aktesh dhune çdo muaj. Por kjo shifër-vëhet re-nuk përfshinë valën e tmerrshme dhune kundër kristiane të regjistruar në Orisa, që përbën një "fletë të zezë" për shoqërinë indiane dhe për vlerat e saj të demokracisë, lirisë, pluralizmit, respektimit të të drejtave vetjake. Raporti këtë çështje e trajton si një kapitull më vete dhe e ndanë në akte. Akti i parë në fund të 2007 dhe fillimit të 2008, ditët menjëherë pas Krishtlindjes, grupe ekstremistësh hindu janë vërsul drejt bashkësisë së krishterë, duke shkatërruar 105 kisha, duke vrarë 9 të krishterë, duke sulmuar dhe përdhunuar gratë, duke djegur më shumë se 730 banesa dhe duke dëmtuar 40 ushtrime tregtare. Bilanci tragjik i aktit të dytë ka qenë: 120 të vdekur (ndër të cilët një prift katolik) dhe mijëra të plagosur, 250 kisha dhe vende lutjeje të dëmtuara, 13 shkolla të krishtera të dëmtuara dhe grabitura, më shumë 54 mijë të pastrehë të brendshëm. Mund të themi se ka qenë viti më i keq për pakicat fetare 30 vitet e fundit.



17-vjetori i veprimtarisë së Misionit Katolik Shqiptar në Luzern të Zvicrës

Zëri i misionit, zë i arsyes

■ SHKRUAN:
Lekë PREÇI, Kriens

Emigrimi i popullit shqiptar nëpër vendet e botës përndimore e ka zanafillën e vet shumë herët dhe kjo ndodh nga pakënaqësitë që i janë shkakuar në atdheun e tyre gjatë shekujve e në veçanti pjesa e dytë e shekullit XX. Shkaqet tashmë janë të njohura. Vetëm në Zvicër shqiptarët e përbëjnë grupin më të madh të mërgimtarëve. rreth 200.000. Migrimi këtu ka filluar para dyzet viteve. Këta shqiptarë edhe pse larg atdheut të tyre, me mundësitë që kanë pasur kanë ruajtur me ndershmëri traditën, gjuhën, kulturën dhe besimin, apo fenë e të parëve të vet. Të gjitha këto elemente dëshmojnë qartë opsinin e një kombi, i cili i bart me vete argumentet kombëtare kudo që gjendet. Prandaj, religjioni është një veçanti e një populli dhe në bazë të lirisë të besimit i rregullon marrëdhëniet e veta ndër njerëzore, me besim të plotë në një Zot të vërtetë. Në Zvicër rreth 20 % të shqiptarëve janë të besimit katolik. Nga kjo masë e madhe e këtyre besimtarëve katolikë shqiptarë në Zvicër, është parë e udhës, si një parim i ligjit mbi lirinë e besimit, si gjithë popujt tjerë që jetojnë në këtë vend, edhe populli shqiptar të ketë strukturat e veta kishtarë në gjuhën e vet, të ketë Misionin e vet sikurse kombet tjera. Herë pas herë para viteve të nëntëdhjeta na vizitonte atë Hil Kabashi misionar i atëhershëm për shqiptarët në Gjermani

Dhe me propozimin e tij kërkesa për të themeluar një Mision në Zvicër është realizuar në vitin 1991.

Zyrtarisht Misioni në Zvicër hapët në vitin 1992. Selia e tij ishte në kantonin e Luzernit. Themelues i Misionit dhe misionari i parë ishte dom Aleksandri Kola, i cili kishte arritur nga Kosova me një vullnet të mirë që t'i shërbej Zotit dhe popullit të vet në mërgim. Ishte një kënaqësi e madhe për popullin, sepse kishte shumë arsye në jetën e tyre në mërgim, dhe ishte një domethenie e veçantë nga se populli shqiptar prezantohet për herë të parë në këtë vend me besim dhe kulturën e vet fetare. Populli zviceran, i cili ka një traditë të gjerë të kulturës, po ashtu dhe të besimit të krishterë ka zbatuar ligjin edhe për popujt tjerë me besime të ndryshme që të përfaqësojnë me misionet e tyre në përputhshmëri me ligjet e vendit pa i cenuar liritë dhe të drejtat e besimeve të tjera.

Gjatë kremtimit të Meshës



Misioni i dom Aleksandrit

Në fillim të Misionit don Leka e pati shumë të vështirë fillimin sepse Zvicra e përbërë prej 26 Kantoneve dhe në të gjitha kantonet kishte shqiptarë, duhej shumë punë dhe mund për t'i gjetur, regjistruar dhe argumentuar se kemi nevojë për Mision. Por ai tregoi shumë sukses në këtë. Së bashku me shumë besimtarë vullnetmirë, arriti të bëjë regjistrimin, të organizojë qendrat ku do të thuheshin meshët dhe ku do të jenë takimet e ndryshme me besimtarë, si në lutje, dhe mësim besimi, përgatitje për kurora kishtarë, krezime etj. Pa dyshim se dom Aleksandri ka udhëhequr misionin e tij me një korrektësi dhe i përkushtuar për shërbim ndaj Zotit dhe njerëzve për tetë vite me radhë.

Në vend të tij erdhi don Marjan Marku në vitin 1999 dhe don Marjan Demaj në vitin 2000. Në vitin 2001 erdhën motrat dhe në vitin 2003 don Mikel Sopi. Kështu duke parë nevojat e besimtarëve, u bë riorganizimi i tri qendrave në Zvicër me tre meshtarë dhe katër motra nderi. Misioni në Luzern, Thurgau dhe Aargau.

Qendra në Zvicrën qendrore me seli në Littau afër Luzernit të cilën e udhëheq don Marjan Demaj në bashkëpunim me motrën Violeta Kola dhe motrën Mrika Sabedini përfshinë edhe Kantonet, Schwyz, Zug, Niedwalden, Obwalden, Uri, Tesinë dhe Valis. Numëron rreth 6500 besimtarë.

Misioni parë filloi dhe vazhdon në Littau të Luzernit

Në këtë qendër të Misionit Katolik Shqiptar është arritur një model i lakmueshëm i sukseseve në sfera të ndryshme të jetës.

Organizimet

Çdo të diele janë të organizuara

nga dy meshë. Dy herë në muaj Sursee dhe Emmenbrücke, pastaj një herë në muaj Inwil ZG, Goldau SZ, Willisau dhe Gornico TI.

Dy herë në muaj në sallën e Misionit bëhen përgatitjet për pagëzime, rrëfimi i prindërve dhe nunave dhe mesha shenjte në kishën e famullisë.

Çdo të shtunë në mbrëmje në Littau mësim besimi me fëmijë, ushtrime me korin e fëmijëve dhe në ora 19.00 me të trituar.

Duhet theksuar se mbi 70 është numri i fëmijëve dhe të rriturve që i japin shije meshës me këndimin e bukur që bëjnë. Një falënderim të posaçëm motrave.

Dy herë në muaj në Goldau, Inwil dhe Willisau po ashtu motrat dhe don Marjani bëjnë mësim besimi dhe nga pak ushtrime për këndim. Këtu duhet veçuar tri grupe të mira që kycen në jetën liturgjike. Në këto takime është edhe rasti i mirë i takimit me prindër dhe fëmijë për dy orë rresht. Nuk mungon as pjesëmarrja e shumtë e fëmijëve dhe prindërve.

Jeta shpirtërore

Disa herë në vit janë takimet e rregullta shpirtërore me gra dhe me vajza. Ndërsa çdo të parë të diele të muajit në mbrëmje takimi me rini në të cilën marrin pjesë mbi 60. Me prindër takimet e rregullta janë çdo dy muaj.

Në vitin e kaluar kemi filluar të parat e premtë të muajit dhe marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i besimtarëve në rrëfim, adhurim për të Shejtrushmit Sakrament dhe meshë. Pas meshë bekimi me të Shejtnushmin Sakrament.

Në përsëritje të rrugës së kryes për ashtu të organizuara nga misioni ynë marrin pjesë numër i madh i besimtarëve.

Dy javë para Pashkëve tash gjatë vite tri ditë me radhë or-



Mons. Dodë Gjergji dhe Don Marjan Demaj

ganzohen ripërtëritje shpirtërore. Këto përsëritje i udhëheqin meshtarët mysafir nga Kosova, Shqipëria apo diaspora.

Organizohet Kungimi parë dhe çdo të dytin vit krezimi.

Jeta kulturore

Në Misionin tonë organizohen edhe takime në aspektin e kulturës sikurse ishte Dhjetëvjetori i Misionit, Kuvendi i Arbrit, pastaj simpoziumi me rastin e përvjetorit të 450-vjetori i Mesharit të Gjon Buzukut, të lindjes së Gjergj Kastriotit, 90-vjetori i lindjes së Nënës Terezë. Disa nga këto u bënë në bashkëpunim me Misionet tjera.

Kontaktet me kishën vendore

Duhet cekur se kontaktet me kishën vendore janë të shumta dhe të shpeshta. Në këtë rast duhet veçuar meshët të organizuara gjermanisht shqip. Në këto meshë marrin pjesë shumë njerëz dhe kemi rast për ta prezantuar kulturën tonë dhe historinë tonë. Deri më tani kemi pasur meshë të tilla në Luzern, Ebikon, Arth Goldau, Emmenbrücke, Littau, Willisau. Në disa vende disa herë me radhë.

Pas meshës kemi përgatitje apëro për të gjithë me specialitete tona, ndërsa zakonisht pijet

i kanë ofruar nikoqirët.

Po ashtu, kontakte të mira kemi edhe me nacionalitetet tjera, e në veçanti me misionin kroat dhe italian.

Humaniteti në vepër

Para Krishtlindjes dhe para Pashkëve mbledhim ndihma për të varfër që besimtarët përgjigjen me shumë dashuri dhe gatishmëri. Motoja është Drita në errësirë dhe deri me tani janë ndarë për të varfër dhjetëra mija franga në shumë vende në Kosovë dhe jashtë saj si dhe individëve.

Po ashtu, në Misionin tonë para Krishtlindjes organizohet një turne në futboll të vogël me qëllim të ndihmave humanitare për të varfër.

Shtegtimet

Misioni ynë organizon shtegtime nëpër Zvicër dhe jashtë saj.

Çdo vit organizohet shtegtime në Lurd, pastaj shpesh herë në Padovë, dhe në raste të volitshme Izrael, Romë.

Ndërsa Në Zvicër, organizohen shtegtime në Mariastein, Einsiedeln, Sakseln.

Për relaksim

Për anëtarë të Korit dhe bashkëpunues të Misionit, organizohen shëtitje nëpër shumë



vende të Zvicrës dhe në fillim të qershorit grill party në vende të hapura ku për një ditë të tërë janë të bashkuar në rend të parë në lutje, në meshën shenjte, pastaj ushqim lojëra të ndryshme, biseda në mes veti.

Motrat çdo vit për ditë të Nënave që festohet në Maj organizojnë festë për to. Në këtë festë marrin pjesë edhe fëmijët me programe të larmishme kushtuar nënave.

Për Krishtlindje dhe Pashkë tani e pesë vite organizohen festat familjare dhe darka e për bashkët. Gjithnjë në këto festa marrin pjesë rreth 500 besimtarë.

Në kuadër të Misionit tonë ekziston forumi katolik rinor të cilin e udhëheqin të rinjtë dhe bëjnë takime të shumta të sferave të ndryshme. Takohen për Shën Valentin, ditën e Flamurit, ditën e Pavarësisë me koncerte të mëdha për mrekulli bëjnë takimet e veta që do tua kishte lakmi shumë kush për një organizim të mirë.

Po ashtu organizojnë takime të përbashkëta dhe shëtitje të shumta sikurse ishin Evropa Park dhe Koblenz në Gjermani si dhe në Lecco, Padovë, Venedik. Kanë edhe web faqen e vet: www.forumikatolikrinor.ch

Misioni ka pranë vetit edhe grupin e mrekullueshëm të valltarëve "Shqiponja" të cilët gjithnjë e më tepër ushtrojnë dhe mësojnë valle burimore shqiptare.

Deri sa nuk ishte botimi i Dritës dhe i Jetës Liturgjike Misioni ynë katër vite rresht në 48 numra botoi Shërbesën e Fjalës duke ua dhuruar fjalën e Zotit besimtarëve dhe porositë, ngjarjet në mision dhe në botë, që ishte një kënaqësi për ta lexuar.

Tani kjo gazetë del tri herë në vit, por me emër të ri sepse ka material informimi dhe formimi

për besimtar: "Zëri Misionit". Në këtë gazetë kontribut japin edhe të rinjtë në materialin që përgatisin.

Kemi edhe ueb faqen e përbashkët www.misioni.ch faqja e misionit tonë është për çdo lakmi duke falënderuar të riun Donatin, i cili krahas obligimeve të veta gjithnjë është i gatshëm dhe frymëzues për ta bërë sa më të përshtatshme dhe tërheqëse për vizitorë.

Për fund

Mund të themi lirisht që Misioni në Luzern bën punë të madhe në organizimin e jetës shpirtërore dhe mban gjallë ndjenjën fetare dhe kombëtare.

Këtë e vërejnë të gjitha moshat e besimtarëve. Sidomos këtë e vërejnë të rinjtë tanë, të cilët janë në udhëkryqin e jetës dhe janë të rrezikuar për t'i humbur vlerat e shëndosha që kanë trashëguar nga familja.

Për këtë Misioni është një vend takimi, afrimi dhe bashkimi i të gjithëve dhe kështu të bashkuar bëjmë fuqinë që e bekon edhe vet Zoti.

Misioni është derë e hapur për të gjithë ata që kanë nevojë për një këshillë, për një fjalë, një ndihmë shpirtërore, por edhe për relaksim, sepse aty punohet dhe veprohet gjithnjë nën frymëzimin e Shpirtit të Zotit dhe me ndihmën e Tij bëhet krejt kjo punë për të mirën tonë dhe brezave të ardhshëm. Sipas misionarit tonë don Marjanit besojmë se së shpejti do të kemi një qendër të re, e cila do t'i përmush kërkesat tona të mëdha për organizime dhe punë edhe me shumë.

Zoti i bekoftë don Marjanin dhe motrat, dhe të gjithë ata që angazhohen për të na bërë jetën më të lumtur në mërgim.

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEJA

Isidori i Sevilës (560–636)

Bazilika e shën Isidorit të Sevilës



gjim, i bindur se asgjë nuk mund të urdhërojë nëse ai vetë më parë e kryen". Isidori ishte orator i madh. Pati rast të jetë udhëheqës i mbledhjes së katërt nacionale në Toledo në vitin 633. Dëshira e tij e flakët ishte që të pasurohej sa më tepër me njohuri romake dhe ato t'ua jepte brezave të rinj. Me punime të ndryshme në këtë lëmi nuk i shërbue vetëm vetes, por u shërbue edhe të tjerëve.

Isidori ishte mësues i madh, sepse lexonte vepra të njerëzve të mëdhenj. Ishte një ndër njohësit më të mëdhenj të kulturës

greko-romake dhe me kujdes të veçantë studioje Biblën, duke u bazuar në shën Jeronimin. Nderonte shumë shkollën biblike të Aleksandrisë. Vepra më e njohur në Shkrimin shenjtë është Questiones in Vetus Testamentum – pyetje që kanë të bëjnë me besëlidhjen e vjetër.

Veprat tjera janë: Zanafilla ose Fillimi në njëzet vëllime. Këtë veprë Isidori e shkroi pak para vdekjes. Këtu është e shënuar etimologjia e botës antike si p.sh. De gramatica, De retorica et dialectica, De quattuor disciplinis mathematicis, De medicina etj.

Veprat tjera kanë të bëjnë me çështje fetare, të cilat flasin mbi fenë katolike, mbi rregullat e eremitëve etj.

Isidori konsiderohet si hero i Kishës në Spanjë. U kanonizua në vitin 1598, ndërsa Inocenti papë e shpalli si mësues të Kishës në vitin 1722. Isidori ishte burrë i mendimit dhe lëvizjeve. Deshi t'i mbetet besnik të vjetrës, duke qenë i vetëdijshëm se duhet të adaptohet edhe në rrethanat e jetës që ishin në shekullin në të cilin jetonte.

Karakteristika e Isidorit si ipeshkëv ishte: ai dëshironte që klerin ta ketë në nivel shumë të lart intelektual dhe për këtë shkolla e Sevilës ishte një ndër shkollat më të njohura për formimin e brezave të reja katolike në Spanjë. Dhe ishte atdhetar i flaktë. Priste dhe shpresonte bashkimin e Spanjës nën udhëheqjen e Gotëve dhe nën flamurin me kryq. Me shpresë se kjo do të ndodhë ai shkruan një përmblidhje të popullarizuar Hispana.



Shën Gregori i Madh në meditim



Krezmimi 2008 në Littau

Ese

“Pâ dhe besoi” (Gjn 20, 8)

Gjurmëve biblike në takim me Krishtin e Ringjallur

S'mund të bëhen reflektime as teologjike e as filozofike, a çfarëdo qofshin ato, po nuk u morën në shqyrtim pjesët e ungjijve që rrëfejnë ringjalljen e Jezu Krishtit. Kemi të bëjmë me tregime letrarisht të veçanta, të shkurtra, të thukëta, qartësisht të shkruara për t'u kuptuar prej shumëkujt. Leximi i ungjillit kërkon një lloj leximi sui generis; supozon dhuratën e fesë. Është përjasje që nuk ngelet vetëm në rrafshin e mendjes, arsyes, në kalkulimet e probabilitetin njerëzore, por përshkohet tej e përtej qenësisë sonë e kap të matanshmen hyjnore, që dhurohet prej vetë Hyjit, Jezu Krishtit, si dhuratë, thesar e hir. Prandaj, të kërkojmë Jezusin e Ringjallur në leximin dhe pranimin e fjalëve të ungjillit, hyjnisht të frymëzuara, do të thotë të ushqesh arsyen dhe fitosh hirin për të kuptuar e për të besuar në Ngjalljen e lavdishme të Tij, për të besuar në praninë permanente në historinë e njerëzimit, e në mënyrë të posaçme përmes trajtës sakramentale të eukaristisë.

■ SHKRUAN:
Don Fatmir KOLIQI

Ringjallja e Jezu Krishtit është themeli dhe qendra e Bashkësisë (Kishës), është shkëmbi i palëkundshëm i krishtenitetit, aty ku ajo mbështetet fuqishëm. Pa Ringjallje (Pashkë) Bashkësia e krishterë do të mbetej e frikësuar, në vajtim të një trupi të vdekur e të varrosur, në kujtim të një mësimi të padëgjuar e brilant të mësuesit të saj, me të cilin i shqetësoi krerët hebre e ata romakë, e që ishte shkaku i ekzekutimit të tij të mizor i kryer nga këta të fundit. Një kujtim, pra, ndoshta i fuqishëm e një revolucion i shënuar në historinë e njerëzimit, një lëvizje ekstravagante përbrenda hebraizmit, një rrymë filozofike a rabinike... Gjithçka do të ngecej në rrafshin tokësor, imanent, pa e kuptuar asnjëherë thellësinë e mësimi dhe veprës së tij. Do të mbetej një dëshitim i dhimbshëm për të vendosur një rend të ri mbarëbotëror.


Porse, ja se ndodhi e kundërta, sepse transcendenca, hyjnorja e tejkaloi, e ngadhënjëu tokësoren, njerëzoren; frika dhe vajtimi u kthehen në *guxim* dhe shprehje *lavdërimi* për Zotërinë e Ringjallur, për Birin e Hyjit; Ai bëri, mundësoj, lejoj që të shihet, të besohet, “të kapet” a “të perceptohet” hyjnia e tij e lavdishme. Bashkësia e krishterë vazhdimisht, me shekuj deri në ditët tona, është pjesëmarrëse e kësaj ngjarje pashkëvore, e kësaj dhurate hyjnore e aftë të shndërrorj truzullin mbarë.

**Rrëfimi ungjillor –
burim i padiskutueshëm i dëshmisë së Ringjalljes**

Meditimi im-ese do të jetë fokusim, veçanërisht, në pjesën e ungjillit të Gjonit, përkatësisht fragmenti 20, 1-9, duke pasur për referim, po ashtu, edhe pjesët tjera të ungjijve sinoptikë (Mt 28, 1-10; Mk 16, 1-8; Lk 24, 1-12) dhe atë të letërës së parë të Gjonit.

S'mund të bëhen reflektime as teologjike e as filozofike, a çfarëdo qofshin ato, po nuk u morën në shqyrtim pjesët e ungjijve të mësipërm që rrëfejnë ringjalljen e Jezu Krishtit. Kemi të bëjmë me tregime letrarisht të veçanta, të shkurtra, të thukëta, qartësisht të shkruara për t'u kuptuar prej shumëkujt. E përndryshe, gjitha këto karakteristika të fragmenteve ungjillore, e jo vetëm këto, kanë qenë “arsye” e dyshimit, mosbesimit e çfarë jo të shumë njerëzve për të mos e pranuar njëmendësinë e Ringjalljes, duke i konsideruar ato pjesë tregimesh të pabaza.

Leximi i ungjillit kërkon një lloj leximi sui generis; *supozon dhuratën e fesë*. Është, pra, një përjasje që nuk ngelet vetëm në rrafshin e mendjes, arsyes, në kalkulimet dhe probabilitetin njerëzore, krejtësisht natyror e fizik, por përshkohet tej e përtej qenësisë sonë e kap të matanshmen hyjnore, që dhurohet prej vetë Hyjit, Jezu Krishtit, si dhuratë, thesar e hir. Prandaj, të kërkojmë Jezusin e Ringjallur në leximin dhe pranimin e fjalëve të ungjillit, hyjnisht të frymëzuara, do të thotë të ushqesh arsyen dhe fitosh hiri për të kuptuar e për të besuar në Ngjalljen e lavdishme të Tij, për të besuar në praninë



permanente në historinë e njerëzimit, e në mënyrë të posaçme përmes trajtës sakramentale të eukaristisë.

Gjoni, ungjilltar dhe nxënësi i dashur i Jezusit, përmes ungjillit të vetë na ka paraqitur ngjarjen e ringjalljes së Zotërisë. Ai ishte, bashkë me Pjetrin, i pranishëm tek varri i zbrazët, pasi ishte marrë lajmi prej grave të devotshme, se Jezusi nuk ishte në varr. Edhe ungjijtë tjerë na japin po të njëjtën ngjarje me disa ndryshime të vogla. Këto janë pra tekstet dëshmi e njerëzve okularë. Gjithçka duhet nisur nga aty e prej tyre.

“Hyri brenda në varr Simon Pjetri, kryeapostulli, mandej edhe Gjoni, pa dhe besoi (Gjn 20, 8), thotë ungjilli. Pa dhe besoi – sa mbresëlënëse janë këto fjalë. Të pamunit e apostullit është të pamunit e fesë, janë sytë e besimit, janë sytë e zemrës së besimtarit. Ai, vërtet, nuk e pa Jezusin e ringjallur, por varri i zbrazët ishte shenja e parë që të besonte se Zotëria është ringjallur.”

Përballja me disfatën e vdekjes apo takimi me gjurmët e jetës

Ditën e Pashkës Bashkësia e krishterë kujton ngjarjen e mëngjesit të së dielës, që ngjau diku rreth vitit 33 p. K. Në *"lindje të diellit"* (Mk 16, 2) lindi një agim i ri, i shndritur e i shenjtë që ndërroi tërë historinë e njerëzimit. Ungjijtë tregojnë gjithë atë se çfarë ndodhi: Maria Magdalenë me disa gra shkuan te varri i Zotërisë, për të kryer ritin e të pamës së varrit. Kur shkuan te varri panë se guri ishte rrokullisur e varri ishte i zbrazët (khs. Gjn 20, 1-2). Të shqetësuar për së tepërmi, gratë e përshtirshme iu lajmëruan nxënësve për të gjitha që kishin parë. Simoni dhe Gjoni u nisën vrap drejt varrit. Hyri brenda në varr Simon Pjetri, kryeapostulli, mandej edhe Gjoni, *pa dhe besoi* (Gjn 20, 8), thotë ungjilli. *Pa dhe besoi* – sa mbresëlënëse janë këto fjalë. Të pamunit e apostullit është të pamunit e fesë, janë sytë e besimit, janë sytë e zemrës së besimtarit. Ai, vërtetë, nuk e pa Jezusin e ringjallur, por varri i zbrazët ishte shenja e parë që të besonte se Zotëria është ringjallur.


Për Gjonin dhe bashkëvëllezërit e tij apostuj nis një epokë e re. *Nis ecja për ta (ri)takuar Krishtin, Mësuesin*. Ndodh kthimi i vërtetë i apostujve. Ata që kishin mbetur të ngjuar në një shtëpi nga "frika" e papërshtirshme e "dështimit" të së Premtes, e që kishin humbur shpresën se do të mund të shohin përsëri Mësuesin e Zotërinë e tyre, tani përsëri ju kthehet shpresa. Takimi me varrin e zbrazët dhe pëllhurën me të cilën ishte mbështjellë Jezusi i tyre hap shtigje të reja. *Mëngjesi i të dielës së Pashkëve iu çel dyert e syve të turbullt, dyert e zemrës së pikëlluar*. Aty të mbyllur kishin qenë si në varr. Mendonin se gjithçka kishte mbaruar. Lajmi i grave i ringjalli, apo më saktë, Mësuesi i ringjallur i ringjalli edhe ata. U ngritën e shkuan të shohin çfarë kishte ndodhur me varrin e Zotërisë së tyre. U ballafaquan me zbrazëtinë e varrit, me *disfatën e vdekjes*. Prandaj *besuan* sepse panë. *Panë disfatën e vdekjes dhe shenjat e ngadhënjimit të jetës*. Ai që kishte paralajmëruar se vdekja nuk ka pushtet mbi Të, tani përfundimisht e dëshmoi duke u ringjallur.

Ungjilli na tregon se nxënësit u kthyen menjëherë për të treguar lajmin edhe nxënësve tjerë. Simbolikë shumë domethënëse që do të kuptohet: *varri s'është më epiqendra, tani i Ringjalluri është epiqendra e tyre*.

Ku të gjendet ai, ku mund ta takojnë. Ungjilli sinoptik na japin një pjesë tjetër shumë të rëndësishme. Gjithçka kishte ndodhur edhe në pranon e qiellit. Ato afër varrit paraqitet prania e engjëllit duke ua dhënë përgjigje grave. Engjëlli u thotë grave: *"Shkoni dhe thuajuni nxënësve të tij – e veçanërisht Pjetrit: Po shkoni para jush në Galile, atje do ta shihni, siç*

ju pati thënë" (Mk 16, 7; khs. edhe Mt 28, 7).

Pse në Galile? Çfarë do Jezusi t'iu tregojë në Galile, pse e zgjodhi pikërisht këtë vend për t'u takuar me nxënësit? Për të kuptuar këtë, do të duhej të bëhej një retrospektivë e jetës para mundimit dhe vdekjes në kryq të Jezusit, kur ai filloi veprën e tij shpërblymtare, si dhe të kujtohet dëshpërimi i nxënësve me kryqin. Fjalët e Jezusit marrin një domethënie thelbësisht teologjike, duke na shpjeguar tek gjurmët e nisjes së veprës së tij. Sepse ata, apostujt, ende nuk i kishin kuptuar Shkrimet, as vetë Mësuesin e tyre. Prandaj gjithçka duhet të rifillojë prej andej ku kishte zënë fill takimi dhe pranimi me Jezusin. Ai vend ishte Galilea. Në ungjillin e Lukës gjejmë: *"Le t'ju bjerë në mend çka ju pati thënë kur ishte në Galile:*



Shën Toma pa Jezusin e ringjallur

'duhet – thoshte ai – që Biri i njeriut t'ju dorëzohet njerëzve mëkatar, ta kryqëzojnë dhe të tretën ditë të ngjallët!" (Lk 24, 6-7). Takimi në Galile do të thotë se Jezusi është po ai që nxënësit filluan *aventurën hyjnore*, po ai që hëngren e pinë së bashku, po ai – me shpirt e trup – që shpalli me fjalë e vepra Mbretërinë e Qiejve. Do t'ju tregojë se nuk ka mbaruar asgjë, përkundrazi gjithçka është vazhdimësi e po shkron në vend, po përmbushet sipas vullnetit të Atit. Jezusi rikthen në kujtesën e tyre gjithçka kishte bërë gjersa ishte me ta para së të vdiste në kryq. Kështu apostujt, dëshmitarët e Ringjalljes s'do të mbesin në lajthitje eventuale se atë që takuan ishte fantazmë.

Dëshmitarët e Ringjalljes

Ringjalla e Jezusit i kishte rikthyer përsëri apostujt në jetën e gëzimit, madje i kishte forcuar. Gjatë shumë takimeve që apostujt patën me Jezusin e ngjallur, ishin plotësisht të bindur se Mësuesi i tyre ishte Biri i Hyjit, i Pavdekshmi që u përvujtërua ta marrë natyrën njerëzore, që atë natyrë ta ngriste në denjësinë e bijve të Hyjit. Sikur që ndodhi lëvizja e madhe e tyre në takim me Jezusin, ashtu tani ata lëvizin që po të Njëjtin t'ua shpallin të tjerëve.

Gjoni në letrën e vet shkruan: *"Çka ishte që në fillim, çka dëgjua, çka pamë me sytë tanë, çka soditëm dhe duart tona prekën, në lidhje me Fjalën e jetës, – po Jeta u shfaq, ne e pamë dhe dëshmojmë dhe ju kumtojmë Jetën e Pasosur,*

“ Pâ dhe besoi” – Gjoni kurrë nuk e harroi atë çfarë pa atë mëngjes të së dielës së Pashkëve dhe besoi fuqishëm se Krishti është Ringjallur. Kjo fe e madhe e tij dhe gjithë apostujve bazohet në të pamunit, dëgjuesit, në të prekunit. Apostujt nuk janë themelues të një religjioni të dalë nga intelektu, nga përsiatjet dhe planifikimet e tyre. Ata nuk shpallin dije njerëzish, sisteme shkollash e lëvizje filozofesh, por ata shpallin Hyjin e gjallë, që u bë pjesë e historisë, Fjalën (Logosin) e mishëruar, të vdekur e të ringjallur. Kjo Fjalë i shtyri të mos jenë të ngjuar, por të lëvizin, të shkojnë në takim e përfaqim të mbarë botës, sepse të mbushur me këtë fe s'mund të mos shpallet dhe kumtohet Jeta e Pasosur. Ja pse ne i festojmë Pashkët, Ringjalljen e Krishtit! As Kisha sot nuk mund të mos e shpallë e të kumtojë të Ringjallurin. Sepse Ai gjithnjë thotë: do të jem në Galile, atje do të më takoni. **”**

që ishte te Ati dhe u shfaq neve – që pamë dhe dëgjua po jua kumtojmë edhe juve që edhe ju të keni bashkësi me ne [...] që gëzimi ynë të jetë i plotë". (1 Gjn 1, 1-4)

"Pa dhe besoi" – Gjoni kurrë nuk e harroi atë çfarë pa atë mëngjes të së dielës së Pashkëve dhe besoi fuqishëm se Krishti është Ringjallur. Kjo fe e madhe e tij dhe gjithë apostujve bazohet në të pamunit, dëgjuesit, në të prekunit. Apostujt nuk janë themelues të një religjioni të dalë nga intelektu, nga përsiatjet dhe planifikimet e tyre. Ata nuk shpallin dije njerëzish, sisteme shkollash e lëvizje filozofesh, por ata shpallin Hyjin e gjallë, që u bë pjesë e historisë, Fjalën (Logosin) e mishëruar, të vdekur e të ringjallur. Kjo Fjalë i shtyri të mos jenë të ngjuar, por të lë-

vizin, të shkojnë në takim e përfaqim të mbarë botës, sepse të mbushur me këtë fe s'mund të mos shpallet dhe kumtohet Jeta e Pasosur. Ja pse ne festojmë Pashkët, Ringjalljen e Krishtit! As Kisha sot nuk mund të mos e shpallë e të kumtojë të Ringjallurin. Sepse Ai gjithnjë thotë: do të jam në Galile, atje do të më takoni.

Ku është Galilea jonë? Atje ku e kur kemi filluar *aventurën me Jezusin, me Kishën!* Atje ku na është shpallur Fjala e ungjillit, atje ku jemi bërë anëtar të bashkësisë së apostujve. Aty ku dëgjohe zëri i apostujve sot, aty ku ndahen sakramentet – në veçanti kungimi – aty, aty është Galilea e çdonjërit prej nesh.

Java e Madhe dhe kremtimi liturgjik i saj

Java e Madhe, që fillon të Dielën e Larit, është e karakterizuar me kremtimet e mistereve të shëlbimit, të cilat Krishti i kreu gjatë ditëve të fundit të jetës së tij. Kjo kohë liturgjike, si vazhdim i përgatitjes më intensive për kremtimin e Pashkëve, duke na mundësuar përthellimin në misterin e Mundimeve të Krishtit, fillon me hyrjen kremtores mesianike të tij në qytetin e Jerusalemit. Në tri ditët e para, liturgjia na ofron mundësinë e meditimit mbi figurën e Shërbëtorit të Zotit (Leximet e Isaisë profet), ndërsa pjesët e ungjillit na flasin për vizitën e Jezusit në shtëpinë e Lazrit, paralajmërimin e tradhtarit dhe përgatitja për Darkën e Mbrame. Pjesa tjetër e Javës së Madhe e përbërë nga Treditëshi i shenjtë i Zotërisë së kryqëzuar, varrosur dhe ringjallur, është koha kulmore e kremtimit të mistereve të shëlbimit tonë.

■ SHKRUAN:
Don Agim QERKINI

Rëndësia dhe e veçanta e kremtimeve të javës së Madhe bën që besimtarët të marrin pjesë në ritet shenjte me më shumë fe dhe dashuri, në krahasim me devocionet tjera popullore.

Kohën e shenjtë të Kreshmëve, kur jemi të nxitur me thekshëm në pendesë, lutje dhe agjërime drejt kthimit dhe përmirësimit të jetës shpirtërore, e përmyllë Java e Madhe e cila ka për qëllim të na udhëzojë në adhurimin dhe meditimin më të thellë të Mundimeve të Jezu Krishtit duke filluar me të dielën e Larit, e quajtur edhe si e Diela e Luleve.

1. E DIELA E LARIT

E diela e larit ka kuptim të dyfishtë: atë të lavdisë dhe të vuajtjes së Zotit tonë Jezu Krishtit, si pjesë përbërëse të misterit të pashkëve. "Hosana të Birit të Davidit! Bekuar qoftë ai që vjen në Emër të Zotit! Mbreti i Izraelit: Hosana në lartësi që qiellore" (Mt 21, 9). Kjo është antifona që shënon fillimin e liturgjisë së të Dielës së Larit.

Emri i vjetër i kësaj të diele në liturgji ishte "dominica de passione Domini" (shek. IV-V), duke vënë theksin në Mundimin e Jezu Krishtit. Më vonë, kjo e diel do të quhet "Dominica palmarum" ose "Dominica in palmis". Ky emërtim është ruajtur deri në ditët tona, vetëm se, me reformën e Koncilit të II të Vatikanit, këto dy shprehje janë bashkuar për të shënuar një mister, atë të pashkëve: "Dominica in palmis de passione Domini" - E diela e Larit e Mundimeve të Krishtit.



Në vendet ku nuk kishte palma, kjo e diel është quajtur sipas lules që përdorej në atë vend, apo edhe të ndonjë ngjarjeje që karakterizonte atë ditë. Kështu, bie fjala, "Pascha florum" ose "Pascha floridum" (Emri i siujdhesës amerikane Floridës); pastaj kjo e diel quhej edhe "Capitulavium", (në Spanjë katekumenët pastrojnë kokën si përgatitje për pagëzim), pastaj "Pascha competentium" (në Gali u jepej simboli i fesë të posa pagëzuarve), "Dominica indulgentiae" (Dita kur amnistoheshin të burgosurit), pra, gjithmonë e lidhur ngushtë me ndonjë ngjarje si përgatitje për kremtimin e pashkëve.

Sipas dëshmiave të Egjerisë, rreth vitit 400 përkujtimi i hyrjes së Jezu Krishtit në Jerusalemin zhvillohej në këtë formë: pas dite, besimtarët bashkoheshin në Malin e Ullinjve për të kremtuar shërbësën e Fjalës, për të hyrë në mbërmje me rrema palmash dhe ullinjsh në dorë drejt qytetit të Jerusalemit. Kah fundi i shek. VIII do të fillojë të zhvillohen procesione më të organizuara, duke përdorur edhe elemente folkloristike dhe dramaturgjike në këtë ceremoni.

Liturgjia e kësaj të Diele ndahet në dy pjesë. *Bekimi i rrembave që vazhdon me procesionin dhe përkujtimi i Mundimeve dhe vdekjes së Krishtit.*

Ditët deri të Enjten e Madhe i përkasin kohës së Kreshmëve dhe karakterizohen nga ngjarjet e fundit të Jetës së Jezu Krishtit.

Në tri ditët e para të Javës së Madhe, liturgjia na ofron mundësinë e meditimit mbi figurën e Shërbëtorit të Zotit, të cilin e përshkruan Isaia profet, e të cilin, qysh të krishterët e parë e kanë identifikuar me figurën e Krishtit. Ndërsa, në pjesën Ungjillit që lexojmë gjatë këtyre tri ditëve, del në pah tradhtari i Jezu Krishtit, Juda Iskariot. Këtë fakt do ta shpall vet Krishti me fjalët: "Përnjëmend, përnjëmend po ju them: Njëri prej jush do të më tradhtojë" (Gjn 13, 21).

Përkundër kësaj, nxënësit tjerë janë në prag të festës së Pashkëve dhe e pyesin Jezusin: ku dëshiron të bëjmë gati Darkën e Pashkëve, duke mos ditur ende se kishte ardhur koha e lavdërimit të Birit të njeriut (khs. Gjnj 13, 31), që s'erdhi për të qenë shërbyer, por për të shërbyer e për të flituar jetën e vet si shpërblim për të gjithë!" (Mt 20, 28).

2. TREDITËSHI I SHENJTË

Festën e Pashkëve në fillim Kisha e ka festuar vetëm një ditë edhe atë natën në mes të Shtunës së madhe dhe të dielës së Pashkëve. Më vonë (gjatë shek. IV) zhvillohet "Treditëshi i shenjtë i Zotërisë së kryqëzuar, varrosur dhe ringjallur". Kremtimi liturgjik i këtyre tri ditëve fillon në mbërmjen e të Enjtes së madhe deri të dielën e Pashkëve.

2.1. E ENJTJA E MADHE

Të Enjten e Madhe, në Darkën e Mbrame me apostuj, Jezu Krishti themelon sakramentin e Eukaristisë dhe të Meshtarisë.

"Ndërsa po banin, Jezusi mori bukën, i dha lavdi Hyjit, e theu, ua dha nxënësvet të vet e tha: 'Merrni, hani: ky është trupi im!' Pastaj mori kelkun, u falënderua, ua dha e tha: 'Pini prej tij të gjithë, sepse ky është gjaku im - gjaku i Besëlidhjes - që do të derdhet për të gjithë në shpërblim të mëkateve. Unë po ju them: që tani nuk do të pi më kësi fryti hardhie deri atë ditë, kur, bashkë me ju, do të pi - një verë të re - në Mbretërinë e Atit tim.' Dhe, pasi kënduan himnin, dolën për të shkuar në Malin e Ullinjve" (Mt 26, 26-30).

Sipas dëshmiave të Egjerisë, në këtë ditë Eukaristia në Jerusalemin kremtohej dy herë, e para



Darka e fundit e Jezusit me Apostujt

pas dite për të përmbyllur kohën e Kreshmëve, pastaj, menjëherë tjetra për të përkujtuar themelimin e Eukaristisë. Kah mesi i shek. IV shumë kisha praktikonin këtë përvojë të kremtimit Eukaristik "*Natale Calicis*".

Liturgjia e kësaj dite përfshinë kremtimin e Meshës së shugurimit të vajrave, të cilën e prin ipeshkvi në bashkëmëshim me meshtarë dhe rregulltarë të Kishës lokale, dhe më vonë atë të Darksë së Mbrame apo themelimit të Eukaristisë. Me këtë Meshë është e ndërlikuar tradita e larjes së këmbëve (traditë e ashtuquajtur *mandatum* – urdhër). Përmes këtij gjesti të Jezu Krishtit ndaj apostujve shprehet qartë porosia e tij që u jep nxënësve; urdhrin e dashurisë dhe të jenë gjithmonë në shërbim të besimtarëve.

Gjatë kësaj meshe shugurohen hostjet edhe për të Premten e madhe. Ato zhvendosen nga vendi qendror i mëparshëm dhe ruhen në tabernakull në kapelë ose në ndonjë vend të përshtatshëm në kishë. Kjo simbolikë shënon rëndësinë e medimit mbi vdekjen e Krishtit dhe përqendrimin e vëmendjes tek varri i tij. Më pas vazhdon zbulimi i lterit kryesor si shenjë zie e mbarë Kishës për vdekjen e Krishtit. Për të theksuar këtë, edhe tradita e Kishës parashihet që të "lavdia" bien zilet dhe kumbonat, të cilat pastaj nuk përdoren më deri në intonimin solem të "lavdisë" së vigjiljes së Pashkëve. Kështu, të premten dhe të shtunën e Madhe, Kisha përkujtohen Mundimet dhe vdekjen e Krishtit në mal të Kalvarit.

2.2. E PREMTJA E MADHE

Shënimet e para për liturgjinë e të Premtes së Madhe i hasim në përshkrimet e Egjerisë, të cilat kishte shkruar gjatë shtegtimin në Tokën Shenjte. Rreth vitit 400 të krishterët e Jerusalemit bashkoheshin në mëngjesin e kësaj dite për të adhruar kryqin, ndërsa në mesditë për liturgjinë e shërbesës së fjalës që përmbilley

reth orës tre. Leximet kryesisht përbënin pjesë nga Mundimet e Jezu Krishtit. Adhurimi i Kryqit bëhej vetëm aty ku kishte relikte të Kryqit, kështu që, ky adhurim bëhej edhe në Romë pasi që perandoresha Helena kishte sjellë si dhuratë një relikte të tillë në këtë qytet. Deri në shek. XI kremtimi i të Premtes së Madhe ka pasur zhvillime, të cilat kanë rezultuar me pjesë të cilat janë ekzistuese edhe sot: Shërbesa e fjalës; Adhurimi i Kryqit dhe kungimi.

Kjo ditë për të krishterët në gjithë botën është ditë agjërimi. Kisha porositi që ky agjërim të mbahet deri në Vigjiljen e Pashkëve.

Kremtimi i liturgjisë së kësaj dite fillon me *prostratio* (shtrirja në heshtje e meshtarit në tokë para lterit), ndërsa të gjithë besimtarët bien në gjunjë. Pastaj, në shërbesën e fjalës vëmendja është e përqendruar në leximin e Mundimeve të Krishtit.

"Kryqi, dru dëmbjesh e vuajtjes, lter gjaku e flije zen vendin e parë në ritet fetare"... Kështu, "me adhurimin e Kryqit besimtarët ndjekin shpirtërisht tragjedinë e Golgotës, të paraqitur aq gjallë e aq theksbëm në Ungjillin e Shën Gjoni" (Meshari i të kremteve, At D. Gjeçaj, Romë 1966).

Pas leximit të Mundimeve të Krishtit mbahet një homili e e shkurtër dhe vazhdohet me *Orationes solemnes* (lutjet e gjithëmbarshme). Më pas bëhet adhurimi i Kryqit për të përfunduar me pjesën e tretë që është kungimi.

Sot, më mirë se kurrë, e kup-tojmë se të kungohesh me Korpin e Krishtit d. t. th. të marrësh pjesë në Flijen e tij – të dish t'i pranosh edhe vuajtjet nga dashuria për të afërmin.

2.3. E SHTUNA E MADHE

Në këtë ditë nuk ka kremtim të Eukaristisë e as të shërbesës së fjalës, por me mendje e zemër lutemi duke përkujtuar Krishtin në varr i cili pret momentin e ngjalljes së vet të lavdishme.

2.3.1. Vigjilja e Pashkëve – Nata e shenjtë

Triduum paschale pjesën qendrore e ka në vigjiljen e pashkëve. Shën Augustini për këtë natë shkruan kështu: *Nata e Pashkëve është "Nata shenjte, nata nënë e të gjitha netëve të krishterimit"*.


Në këtë vigjilje, Kisha pret me vigjilencë ringjalljen e Krishtit. I gjithë kremtimi duhet të mbahet natën, kështu që fillon pasi të bie nata ose duhet të përfundoj para agimit të së dielës.

Vigjilja e Pashkëve sot përmban këto katër pjesë:

- 1) **Shërbesa e dritës:** Bashkësia gjendet afër qiriut të Pashkëve që është simbol i Krishtit, dritës së botës.
- 2) **Shërbesa e fjalës:** Kur menjëherë mbi veprat e mrekulueshme të cilat që nga fillimi Zoti i ka bërë në popullin e vet.
- 3) **Shërbesa e pagëzimit:** Sakrament ky përmes së cilit kalojmë nga vdekja në jetë. Bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit, dhe
- 4) **Shërbesa eukaristike:** Populli i Zotit i rilindur me pagëzim paraqet flinë në Përkujtim të Krishtit, si shenjë falënderimi dhe ushqehet me Korpin e Krishtit të ngjallur.

Nga përmbajtja e liturgjisë e natës së shenjtë, e cila është më e pasura për nga ritet shenjte, po veçoj disa prej momenteve dhe simbolikës që e karakterizojnë atë, me qëllim që ta njohim dhe përjetojmë më mirë këtë kremtim solem.

Shërbesa e dritës fillon me bekimin e zjarrit, prej të cilit do të ndizet qiri i pashkëve. Zjarri është simbolikë e jetës që shndrit dhe ngrohet. Më pas në qiriun e Pashkëve gdhendet kryqi mbi të cilin vihet shkronja greke Alfa ndërsa nën të shkronja Omega. Në katër anët e kryqit vihen katër numrat e vitit vijues, pastaj mund të vihen pesë kokrrat e kemit po ashtu në formë kryqi. Prej zjarrit të bekuar ndizet qiri i Pashkëve, që simbolizon Krishtin e Ngjallur.



Pasi të jemi nisur drejt kishës, në hyrje të saj të gjithë ndezin qirinjtë që bartin në dorë nga qiri i Pashkëve (Populli i Zotit udhëton në këtë botë i shndritur me dritën e Krishtit). Atëherë xhakoni, ose nëse ai nuk është, meshtari duke e lartësuar qiriun e Pashkëve këndon në hyrje të kishës, në mes dhe të lterit: *Drita e Krishtit*, në çka të gjithë përgjigjen: *Falënderojmë Hyjin*.

Pasi të vihet qiri në shandan këndohet himni i qiriut të Pashkëve. Ky himn përmban pesë tema: *a) Ngjallja është krijim i ri; b) Dalja; Qiri si udhëbregues i popullit (Dalja nga Egjipti); c) Qiri është dritëza e Kishës e cila pret të Fejuarën e vet; d) Domethënia e paraqitjes së dritës dhe karakteri flitues i Pashkëve; dhe e) Simbolika e bletëve*.

Pasi të ketë përfunduar himni të gjithë fikin qirinjtë dhe ulen, vazhdon shërbesa e fjalës.

Për shërbesën e fjalës janë të paraparë shtatë lexime prej Besëlidhjes së Vjetër dhe dy prej Besëlidhjes së Re. Leximet e BV mund të reduktohen në më së paku dy, por asnjëherë nuk guxon të lihet leximi mbi daljen prej Egjiptit (Leximi i tretë).

Pas leximit të fundit të BV dhe lutjes meshtari intonon "lavdinë"..., ndërsa vijon lutja dhe leximi i letër nga BR. Kur kjo përfundon solemnisht pas shtatë javësh këndohet *Alleluja*. Vazhdon Ungjilli dhe homilia.

Në shërbesën e pagëzimit nëse ka katekumenë (të rritur për pagëzim) bëhet paraqitja e tyre si dhe e nunave, e nëse nuk ka asnjë për pagëzim ftohet bashkësia në lutje dhe bëhet bekimi i ujit. Nuk thuhet litanitë, ndërsa bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit. Lihet Besojma.

Shërbesa eukaristike është shërbesa qendrore e këtij kremtimi me të cilën shprehet kuptimi themelor i saj: Me Krishtin kalojmë nga vdekja në jetë. Mesha vazhdon si rëndomë me prefacion dhe lutjet përkatëse.

E DIELA E PASHKËVE

Meqë kremtimet e vigjiljes së Pashkëve mbaheshin gati deri në mëngjes dhe përmbilleshin me kremtimin Eukaristik, në kohët e mëhershme nuk është kremtuar Mesha në mëngjesin e së dielës së Pashkëve. Vetëm pasi vigjilja e pashkëve fillon të kremtohet më herët atëherë edhe mesha e paradites e së dielës së Pashkëve do të filloj të shndërrohet në Meshën solemne të Pashkëve.

Ky kremtim solem do të vazhdoj gjatë gjithë kohës së Pashkëve, kur në mënyrë të veçantë këndohet "*alleluja*" e ngadhënjimit të Krishtit mbi vdekjen, edhe atë, prej të dielës së Ringjalljes deri të dielën e Rrëshajave (50 ditë), duke kremtuar me lavd dhe gëzim si të ishte kjo kohë një ditë e vetme feste, për më tepër si e "diela e madhe".



Udhë e Kryqit në Lurd



Intervistë me nënën Zojë Thaqi nga Trepetica

Një jetë me peripeci, por edhe me fe dhe shpresë në Zotin

Në këtë numër lexuesve të revistës sonë "Drita" do t'ua sjellim një intervistë me nënën e tetë fëmijëve, tani gjyshe e shumë nipave dhe mbesave, e cila në jetën e vet ka përjetuar raste shumë të rënda dhe është ballafaquar në të njëjtën kohë me forcën e fesë dhe të besimit në Zotin. Ajo, edhe pse me moshë të shtyrë (67-vjeçare) dhe me shëndet jo fortë të mirë, prapë se prapë ruan shumë mirë kujtimet e saja të fëmijërisë dhe të jetës në përgjithësi dhe e ka një mendje (që ajo e quan kompjuter) shumë të shëndoshë. Shpresojmë që përvoja e saj të jetë e dobishme dhe tërheqëse edhe për jetën e lexuesve tanë. Dikush pati thënë se në një popull, kur gjyshet lexojnë, ai popull është afër ardhmërisë së ndritshme.


Drita: Nëna Zojë, a mund të na tregoni me disa fjalë prejardhjen tuaj dhe në përgjithësi vitet e para të fëmijërisë suaj?

Po, patjetër. Jam e lindur në fshatin Mejë, komuna e Gjakovës, në vitin 1942. Por jam e rritur në fshatin Jahoc. Në moshën tetëvjeçare e kam përjetuar vdekjen e babës, do të thotë në vitin 1950 ka ndërruar jetë babai im. Fëmijëria e jonë, e familjes sonë por edhe e tjerëve ka qenë vërtet shumë e vështirë. Kemi jetuar në një varfëri të skajshme. Kemi pasur vetëm një dhomë të mbuluar me kashtë dhe në këto kushte jetonim ne: nëna ime, tre vëllezërit dhe tri motrat. Pra, një gjendje shumë e vështirë. Do të thosha që fëmijërinë e kemi jetuar në mjerim. E kam pasur rastin të shkoj në shkollë për dy vite dhe më kujtohet akoma emri i mësuesit Sylejman Dulaj dhe Nanie Vokshi. Dëshira ime ishte që të vazhdoj shkollimin sa që edhe mësuesi erdhi dhe e luti familjen, por edhe kjo shkoi pa sukses. Ishte një kohë vështirë, në veçanti pas vdekjes së babës. Në moshën katërmëdhjetëvjeçare përjetova edhe një dridhje, më fejuan, në këtë moshë shumë të re. Pas dy vjetëve fejesë edhe më martuan. Martesa gati po thuajse ishte pa dëshirën time, sepse isha e re, por ishte vend-

imin i prerë i familjes. Ajo çka më brengoste më se shumti, ishte se nuk kisha kurorë dhe më lindi fëmija i parë pa pasur kurorë kishtarë. Dhe në atë kohë nuk kishim të drejtë të shkonim në kishë me fëmijën (do të thotë të bëhet pagëzimi) pa pasur prindërit kurorën shenjte. Në atë kohë ishte meshtar don Nikollë Mini, ishte meshtar shumë i rreptë. Ia kishim frikën. Por ia shpjegova se kjo gjë nuk varej prej meje, se nuk kisha vendosur unë për një gjë të tillë dhe se krejt kjo ishte një vendim i familjes. Unë në të vërtetë nuk dija mirë dhe se çfarë ishte martesa. Atëherë ai na ndihmuar për të shkuar në vend të gjitha punët. Jemi rrefyer, jemi kurorëzuar dhe kemi pagëzuar vajzën e parë Marinë. Ky ka qenë momenti ndoshta që e ka kthyer jetën tonë për se mbari.

Drita: Cilat kanë qenë momentet më të mira dhe ato më të vështira të jetës sate?

Po dëshiroj të filloj prej atyre momenteve të hidhura, sepse e kanë plagosur rëndë shpirtin dhe jetën time. Dhe për këtë arsye dëshiroj të flas pikë se pari për këto. Momenti i parë i vështirë ka qenë vdekja e babait, siç e theksova edhe me herët, kur unë kisha vetëm 8 vjet. Ishte një dhimbje e madhe, ndonëse dikush mund të mendojë që nuk kuptoja vërtet çka do të thotë vdekja e prindit, por kjo nuk ishte e vërtetë. Unë e kam kuptuar dhe e kam ndier shumë thellë dhimbjen për vdekjen e babait tim të dashur. Kjo ka qenë plaga e parë e jetës sime që të rritem pa babë. Plaga apo dhembja e dytë ka qenë kur në vitin 1974 është



Kisha e shën Nikollës në Velezhë

“ Kemi pasur vetëm një dhomë të mbuluar me kashtë dhe në këto kushte jetonte nëna ime që kishte edhe tre djem dhe tri vajza. Pra një gjendje shumë e vështirë varfërie. Do të thosha që fëmijërinë e kemi jetuar në mjerim ”

sëmure burri im dhe pas gjashtë vjet sëmundjeje dhe vuajtjesh të mëdha në vitin 1980 ka ndërruar jetë. Ishte në moshën 46-vjeçare. Dhe momenti i tretë ishte ai më i tmerrshmi, kur në vitin 2002 më vdiq djali, në moshë shumë të re. Dhe prej të tri momenteve më të vështira, ky i fundit ka qenë më i vështirë për ta përballuar.

Drita: Na thuaj diçka për momentet e mira të jetës suaj, cilat i kujton më së miri?

Po sigurisht që nuk kam munguar edhe momentet e mira në jetën time. Ndoshta periudha e jetës më e mira ka qenë ajo prej vitit 1960 deri në vitin 1974. Ishte kjo periudhë kur nuk kemi pasur shumë trazira dhe e kemi pas një lloj qetësie deri sa ia behu sëmundja e burrit. Pa tjetër martesa e djalit të parë dhe djemve tjerë më vonë kanë qenë një gëzim i veçantë, edhe pse kjo ndodhi në kushte shumë të vështira. Gëzim të madh pata kur vajza ime pati vendosur të ndjekë një rrugë të posaçme, të ndjekë rrugën e Zotit dhe të bëhet motër kishe. Këtu kam pasur ndjenja, sikur familja ime disi ishte miqësuar me Zotin. Dhe kjo ka qenë një pasurim i veçantë, sepse këtu kam lidhur atëherë edhe raporte të mira me motrat në Cetinjë dhe në vendet e ndryshme ku ato shërbejnë. Dhe me këtë rast ia kam kush-tuar shën Nikollës vajzen time. Këtu nuk guxojmë të harrojmë pa i falënderuar motrën Johan-nes dhe motrat e tjera që i kanë ndihmuar bijës sime në marrjen e këtij vendimi në jetën e saj.

Nuk kanë munguar edhe mo-mentet tjera e sidomos tani nipat dhe mbesat janë gëzim shumë i madh për mua, një nënë plakë.

Drita: Nëna Zoje, kam dëgjuar se lutja është një pjesë e rëndësishme e jetës suaj dhe se ju keni dëshirë të luteni. A mund të në flisni diçka për lutjen?

Po, si jo. Lutja është shumë e rëndësishme për jetën e njeriut dhe të çdo besimtar. Mendoj që kulmi i lutjes është mesha e shenjtë. Besimtari që nuk merr pjesë në meshën shenjtë, është si toka pa ujë dhe pa diell. Lutja ka qenë gjithmonë dëshirë e flakët e jetës sime. Por kam pas edhe momente kur ndoshta jam "hi-dhëruar me Zotin", më gjithë atë kanë qenë momente kaluese. Në fëmijërinë time nuk jam lutur edhe aq shumë. Kanë qenë lutje të shkurtra, më shumë vetëm si shprehje: Na ndihmo o Zot, ki mëshirë për ne...etj. Kam filluar të lutem atëherë kur në moshën 38-vjeçare e kam përjetuar vdek-jen e burrit. Këtu i kam filluar t'i kushtohem Zemrës së Krishtit dhe i kam mbajtur rresht për 21 vjet të premtet e para të muajt. Dhe kjo ka qenë një pasurim i veçantë, sepse këtu kam lidhur atëherë edhe raporte të mira me motrat në Cetinjë dhe në vendet e ndryshme ku ato shërbejnë. Dhe me këtë rast ia kam kush-tuar shën Nikollës vajzen time. Këtu nuk guxojmë të harrojmë pa i falënderuar motrën Johan-nes dhe motrat e tjera që i kanë ndihmuar bijës sime në marrjen e këtij vendimi në jetën e saj.

shumë Zotin që të vdes në Hi-rin e Tij Shenjtëruës. Lus më se shumti rruzaren shenjtë. Tri pje-së rruzare në ditë. Për shpirtin të purgatorit nuk harroj kurrë pa e thanë, duke i kujtuar të vdekurit dhe i lus që edhe ata të luten për mua. Kur flas për lutjen dëshiroj më e lidhë edhe leximin. Kur kam kohë dhe sidomos kur jam mirë me shëndet dy orë në ditë ja kushtoj leximit. Librat që i kam, gati po thuajse janë libra të fesë. Kënaqem kur më mundësohet leximi. E ndiej si një ripërtirje të shpirtit.

Drita: Keni qenë këtu gjatë kohës se luftës dhe keni përjetuar mjaft rëndë, ndër tjera si të gjithë shqiptarët këto momente të vështira. A mund të na përshkruani pak me disa fjalë?

Po sigurisht lufta ka qenë një moment shumë i hidhur i popullit tonë shqiptar, i cili ka qenë gjithmonë i robëruar. Duke filluar prej turqve, pastaj komu-nizmit e se fundit prej armikut të madh të popullit tonë prej Milloshit. Kanë qenë momente të errëta që kanë sjellë frikë dhe tmerr. Fshati i ynë Trepetica ja ka fal kombit dhe lirisë një djal, dhe për këtë jemi shumë krenar. Ky është Pal Paluca. Ky trim ish-te një djalë shumë i mirë. Kish-te shkua në gurbet si të gjithë bashkëkohanikët e tij për të fi-tuar një dinar. Dhe kur ra lufta, dashuria për atdheun bashkë me shumë shokë dhe miq e thërrret që të kthehet për të mbrojtur vendin dhe e vrasin forcat serbe. Ky trim dhe shumë tjerë si Pali

janë shembull i mirë i dashurisë për vendin tonë. Të gjithëve Zoti ua shpërbleftë më të mira të veta. Pushofshin në paqen e Zotit.

Drita: Prej kohës suaj deri me tani kanë pësuar shumë ndryshime dhe trans-formime në shoqërinë tonë. A mund të na thoni si i përjetoni këto ndryshime?

Po sigurisht që ka shumë ndryshime dhe ndoshta nga një herë ne pleqtë nuk pajtohemi më disa situata që na bie hise t'i jetojmë sot. Megjithatë, ka shumë gjëra që kanë ndryshuar për se mbari dhe disa tjera që po shtynë kah shkatërrimi shoqëri-në tonë. Ka ndryshime pozitive, ngase atëherë ka pasur shumë padrejtësi dhe pabarazi në shu-më familje, e sidomos në familjet e mëdha. E mos të flasin për të drejtat e grave ku para disa ditëve e kemi kremtuar edhe 8 marsin. Përpara, edhe pse ndoshta nga frika apo nga tradita, prapë se prapë ka pasur shumë më shumë respekt dhe dashuri për njeri-tjetrin. Tani ka shumë më shumë interes për t'u pasuruar dhe për të fituar pushtet. Përpara familjet kanë luftuar që mos të koriten, tani kanë frikë mos të fiken, dhe janë shumë më koprracë. Për-para, mendoj, familjet tona kanë qenë më bujare dhe më të ha-pura. Tani po shkon çdo famil-je duke u ngushtuar dhe duke u mbyllur në vetvete. Më pengon shumë veshja e vajzave tona e si-domos kur ato dalin apo shkojnë në kishë. Më duket se krejt janë çoroditë. Duhet pasur më shumë kujdes këtu.

Drita: Duke falënderuar për kohën dhe për shembu-llin e mirë në jetën tuaj, ju kërkohet në fund të na jepni disa porosi për lexuesit dhe për besimtarët e sidomos për nënat tona të krishtera.

Po, menjëherë. Mos harroni se jeta është një luftë që duhet vazhdimisht të luftohet dhe do të dalim ngadhënjyes bashkë me Krishtin. Mos e harroni kurrë meshën shenjtë dhe sakramentin e rrëfimit ku ne pajtohemi me Zotin dhe më njani-tjetrin. Mos lejoni më që jeta juaj të jetohe-t pa fe dhe besim. Për mua feja ka qenë një mbështetje e jashtëzakonshme. Kurrë nuk kam dyshuar në Provaninë Hyjnore. Gjithmonë e kam përjetuar që Zoti është afër meje dhe i dë-gjon lutjet e mia. Këtë ndoshta pak më vështirësi në momentet e rënda. Dijeni se shtëpia e për-jetshme për ne njerëzit është qielli. Mos harroni ju familje që, çdo vatrë, çdo familje është një Mbretëri e Zemrës së Krishtit. Mos i harroni të varfrit dhe të dobëtit, nëse nuk dëshironi që t'ju harrojë Zoti. Pastaj shumë me rëndësi është edukimi i fëmi-jëve. Sidomos i ftoj nënat, që të kujdesen shumë për një edukim sa më të shëndoshë për fëmijët e tyre. Sepse thotë një fjalë e urtë popullore: shtofit qyryja anën e qikës qyryja nanën.

(Interviewoi:
Don Jeton THAQI)

“ Fshati ynë Trepetica ia ka falur kom-bit dhe lirisë një djalë dhe për këtë jemi shumë krenar. Ky është Pal Paluca. Ky trim ishte një djalë shumë i mirë ”

Nëna Zoje gjatë leximit të revistës "DRITA"



Për të kuptuar sa më mirë jetën e një nëne shqiptare, po i sjellim vargjet e Nënë Terezës.

Jeta është mundësi, përfito nga ajo!
Jeta është e bukur, admiroje!
Jeta është lumturi, shijoje!
Jeta është ëndërr, realizoje!
Jeta është sfidë, përballoje!
Jeta është lojë, luaje!
Jeta është detyrë, kryeje!
Jeta është shtrenjtë, çmoje!
Jeta është pasuri, ruaje!
Jeta është dashuri, shijoje!
Jeta është mister, zbuloje!
Jeta është premtim, plotësoje!
Jeta është këngë, këndoje!
Jeta është dëshpërim, kaloje!
Jeta është përleshje, pranoje!
Jeta është fat, bëje!
Jeta është aventurë, kujdes!
Jeta është e çmuar, mos e shkatërro!
Jeta është jetë, lufto për të!

Kthimi i Saulit - tradhti apo ndërgjegjësim?

"Njohja e shën Palit mund t'i dhurojë forcë çdo njeri që, pasi të ketë reflektuar mbi të kaluarën, të përbuzë të tashmen dhe të përgatitet për një të ardhme të sigurtë, kur nuk do të jetojë më për vetë dhe për interesat e kësaj bote, por për Krishtin, qëllimin dhe arsytin e krijimit".

■ SHKRUAN:

Don Marjan UKAJ, Toronto

Kthimi i Saulit në krishterim konsiderohet si një ndër kthimet më të mrekullueshme dhe më dramatike në tërë historinë e Kishës. Gjithçka filloi në sinagogën e Libertinëve në Jerusalemin. Mendohet se në atë kohë në të gjithë mbretërinë romake kishte rreth 4 milionë judenj, në Palestinë rreth 2 milionë e gjysmë, ndërsa Jerusalemi ishte qyteti më i bukur i Lindjes, me rreth 400 sinagoga. Në sinagogën e lartpërmendur Shtjefni, që ishte një ndër shtatë shakonët, i frymëzuar nga Shpirti Shenjt, e mbajti një fjalim të zjarrtë, mbi rolin e popullit të Izraelit në historinë e shpëtimit dhe mbi Moisiun si udhëheqës i popullit të zgjedhur. Këtë e dëgjoi edhe Sauli, i cili "e dha pëlqimin e vet për vrasjen e Shtjefnit" (Vap 7, 56. 60). Një gjë të ngjashme do e shikojë edhe Sauli pas një kohe të shkurtër. Shën Augustini, që edhe vet e përjetoi një kthim të veçantë nga hendeku i epshëve në atë të parajsës shpirtërore, mendon se kthimi i Saulit filloi në martirizimin e Shtjefnit dhe në lutjen e tij për salvuesit: "Si martyr Stephanus non sic oras set, Ecclesia Paulum non haberes" që përkthehet në shqip "Po të mos lutej ashtu Shtjefni martir, Kisha s'do e kishte Palin."

Sauli i thart shumë i ndërgjegjshëm i judaizmit, kaloi në një "sekt" të ri, i cili deri atëherë aq shumë e neveriste, saqë e luftonte me mish dhe shpirt. Ky kalim ndodhi, pikërisht, ndërsa ishte në rrugë për t'i përndjekur dhe asgjësuar të gjithë ata që i besonin kësaj "ideologjie", që, sipas mendimit të tij, e "përbuzte" emrin e Zotit dhe traditën e tyre. "Është mirë të theksojmë se njohjet e para mbi Krishtin Sauli i fitoi përmes dëshmisë së bashkësisë së krishterë në Jerusalemin. Ky takim ishte mjaft i stuhishëm. Pas njohjes së kësaj bashkësie të re, u bë përndjekës i ashpër i tyre. Këtë e pranoi edhe vet me tre letrat e ndryshme ku deklaroi: "e kam salvuar Kishën e Hyjit" (1 Kor 15, 9; Gal 1, 13; Fil 3, 6). Duket qartë se ai e përjeton këtë veprim si aktin më të shëmtuar të jetës (Papa Benedikti në audiencën e dt. 22 nëntor 2006)." Kur Pali flet për kthimin e vet që ndodhi drejtpërdrejt nga Krishtit i ringjallur tregon se është i zgje-

dhur qysh në kraharonin e nënës për ta njohur Krishtin dhe për t'u bërë apostull i paganëve (Gal 1, 15-16; 2 Kor 4, 1. 5) dhe thekson se kët detyrë e ka plotësuar tre vite me radhë dhe pastaj është kthye në Jerusalemin (Gal 1, 17). Supozohet se aty i ka fitua ato të dhëna të "Besojmë-s" që gjinden në 1 Kor 15, 3-7. Thirrja e Zotit, të njohurit e Jezu Krishtit si Bir i Hyjit, vetënjohja si mëkatar, detyra e veçantë për misionar të popujve dhe sigurria e të ngjallurit nga të vdekurit në ditën e gjyqit, ishin gjërat që në Palin formuan një njësi të pandashme: "Ungjilli që ju kam predikuar, nuk është vepër njerëzish, por zbulim i Jezu Krishtit" (Gal 1, 11-12).

Ngarja në rrugë për Damask krejtësisht ia ndërroi jetën. Ishte ky një ndryshim në shpirt që e tregon edhe simbolika e ndryshimit të emrit nga Saul (në shqip - i madh, vigan, kolos) në Paul - Pal (i vogël, i pafuqishëm). Kali dhe ushtari, krenaria dhe forca, rrëzohen dhe dorëzohen para Dritës dhe Fjalës, Ndërgjegjes dhe Realitetit. Edhe Saulin Zoti e thirri dy herë (Vap 9, 4; 22, 7; 26, 14), sikur që shumë shpejt më parë e kishte thirrur Abrahamin (Dal 22), Moisiun (Dal 3) dhe Samuelin (1 Sam 3). Në Shkrimin shenjt, kur një emër përsëritet dy herë ka të bëjë me një ndërhyrje të thellë të Zotit në jetën e një personi si dhe ndërrimin rrënjësor të tij. Kjo shihet qartë të Pali. Ai nuk do ta mbajë më emrin Saul, nga mbreti i famshëm, i cili i kundërshtoi Zotit dhe e përndoqi Davidin. Në një mënyrë të tillë Jakobi bëhet

shprehin qëndrimin e tij në fe. "Shën Pali "për arsye të së vërtetës ishte i gatshëm të hiqte dorë nga sukseset e jashtme, të barte përndjekjet dhe mundimet. Në botë, në të cilën rrena ka fuqi, e vërteta paguhet me vuajtje. Kush dëshiron të shmangë vuajtjen, ta largojë atë nga vetja, ai largohet nga jeta dhe madhështia e saj dhe nuk mund të jetë as shërbëtor i së vërtetës, por as i fesë (Papa Benedikti XVI)."

Vuajtja dhe përndjekjet

Shën Pali në letrat e si shpesh herë përshkruan edhe vuajtjet personale, të cilat i barti si pasojë e besimit në Krishtin. Prandaj, qitje gjithmonë anash nga judenjtë e grekët me shtetësi romake dhe karakterizohej si një "kryengritës", për çka përjetoi tortura të ndryshme trupore dhe burgime (2 Kor 11, 16-31; Vap 14,

shkojë në Jerusalemin prej judenjve, ndërsa mbledhja e lëmoshës e zyrtarizon Palin si themelues të Caritasit të Kishës Katolike.

Pali kopje e gjallë e Krishtit dhe model i kthimit tonë

Në veprimtarinë apostolike të shën Palit nuk mungonin vështirësitë, me të cilat ballafaqohej për dashuri ndaj Krishtit. Vet e theksoi se ishte: "i lodhur, në burg, i rrahur, në rrezik të vdekjes. Prej judenjve mora pesë herë nga tridhjetë e nëntë frushkuj! Tri herë kam qenë rrahur me thupër, një herë vlarë me gurë, tri herë e kam përjetuar anijmbytjen, një natë e një ditë e kam kaluar në valët e detit! Në udhëtime të shpeshta, në rreziqe lumenjsh, në rreziqe cubash, në rreziqe bashkatdhetarësh, në rreziqe paganësh, në rreziqe në qytet, në rreziqe në shkretë, në rreziqe në det, në rreziqe prej vëllezërve të rrejshëm! Në mundim e të lodhura, në net të kaluara shpesh pa gjumë, në uri e në etje, në agjërime të shpeshta, në të ftohtë dhe i zhveshur!... Nëse duhet të lëvdohem, do të lëvdohem me ligshitet e mia. Prandaj, kënaqem në ligështi, në sharje, në vështirësi, në salvime e ngushtica që më bëhen për shkak të Krishtit! Sepse, kur jam i ligshët, atëherë jam i fortë!" (2 Kor 11, 23-27, 30; 12, 10).

Sipas studiuesve, Pali bëri 30.000 km rrugë si misionar i Ungjillit. Kishte dëshirë të përhapte atë deri në fund të botës, e fundi i kufijve të botës në atë kohë ishte Spanja (kth. Rom 15, 24. 28). Shejti Atë Papë Benedikti XVI me 8 nëntor 2006 tha: "Krishti u bë arsyeja e jetës së tij dhe motivi i thellë i gjithë veprimtarisë së tij apostolike. Në shkrimet e veta, pas emrit të Zotit, i cili lajmërohet mbi 500 herë, emri që më së tepërmi përmendet është ai i Krishtit (380 herë)". Pali aq shumë ishte mbushur me Krishtin sa që dëshiron të marrë pjesë në vdekjen e tij: "Po a nuk e dini se të gjithë sa jemi pagëzuar në Jezu Krishtin, jemi pagëzuar në vdekjen e tij?...Po kështu edhe ju: mbajeni veten se jeni të vdekur për kah mëkati, e të gjallë për Hyjin në Jezu Krishtin!" (Rom 6, 3. 11). Shën Pali na mëson: "Nëse Hyji na përkrah, kush do të jetë kundër nesh?...Po plotësisht i bindur se as vdekja, as jeta, as enigma, as pushtetet, as e tashmja, as ardhshmja, as fuqitë, as forcat e lartësisë, as ato të humnerës dhe asnjë krijesë tjetër, nuk do të mund të na ndajë prej dashurisë

së Hyjit, që na u dëftua në Jezu Krishtin, Zotin tonë." (Rom , 31. 38-39). Andaj, jeta jonë e krishterë bazohet në Shkëmbin më të fortë dhe më të sigurt që mund të imagjinohet. Nga Ai i nxjerrim fuqitë tona, siç shkruan apostulli: "Gjithçka mundem me ndihmën e Atij që më jep fuqi!" (Fil 4, 13), sepse "e di se kujt i kam besuar dhe jam i sigurt se Ai është i zoti ta ruaj thesarin që m'u besua deri në atë Ditë" (2 Tim 1, 12).

Shën Gjoni në fillim të Ungjillit të vet shkruan: "Drita e vërtetë që shndrit çdo njeri, erdhi në botë" (Gjn 1, 9). Pali e përjetoi këtë dritë me tërë fuqinë e saj. Ajo ia ndali hovin në marshimin e tij në Damask (Vap 9, 3; 22, 6; 26, 13). E rrëxoi për tokë. Edhe Moisiu e përjetoi një dritë të tillë të kaçuba e ndezur (Dal 3). Flaka e Zotit pastorn, nuk dëgj (Dal 3, 2). Shën Pali është i ndriqur drejtpërdrejt me dritë nga qielli. Pasi që e përjetoi vetë, shkruan: "Po, dikur ishit errësirë, por tani jeni dritë, në Zotërinë. Jetoni porsij bij të dritës!" (Ef 5, 8; 1 Sel 5, 5; Kol 1, 12). Drita që e verbëroi Saulin në rrugë për Damask ishte po ajo që apostujt e panë në malin Tabor. Një cast i shkurtër mjaftoi për t'ia ndryshuar jetën. Tri ditë Sauli e përjetoi errësirën dhe gjatë këtyre ditëve agjërroi dhe bëri pendesë (Vap 9, 9). Sauli lufton me errësirën e shpirtit dhe atë të mendjes dhe këtë luftë duhet ta fitonte me forca të veta. Ishte i lirë, por jo i vetmuar, në vuajtje po, por jo i braktisur. Luftoi për ta zhdukur errësirën njerëzore, në mënyrë që t'i bënte vend Dritës hyjnore, e cila do ta bënte atë "një ndër apostujt më të mëdhenj të krishterimit, një ndër personalitetet më të mëdha të historisë së njerëzimit, njeriun, i cili i dhuroi gjë në të madhërseshme kulturës Perëndimore, e kjo është: besimi në njeriun, besimi në të vërtetën që na liron, besimi në një botë më të mirë, një botë të dashurisë, një botë të paqes. E gjithë kjo buron nga besimi në Jezu Krishtin, nga besimi në Atin e Zotit tonë Jezu Krishtit, nga ai i fuqisë jetësore të Shpirtit Shenjt, nga besimi në dashurinë e Atit dhe Birit (C. Tomić, Savao Pavao)."

Në rrugë për Damask Pali u ndal papritmas. Forca e tij nuk mund t'i përballonte fuqisë hyjnore dhe ai u rëzua prej kalit, ndërsa zëri: "Saul, Saul, pse po më salvon? (Vap 9, 4)" nuk e la të qetë. Pali ishte i sigurt në veprimin e tij dhe s'mund t'i shkonte në mend se është salvues. Përkundrazi, ishte shumë krenar që i luftonte të krishterët. Në përgjigjen: "Unë jam Jezu që të e salvon!" e kuptoi thellbin e porosisë hyjnore. Ai de-



shi të hynte në Damask për t'iu hakmarrë Ananisë dhe për të terrorizuar të krishterët, ndërsa tani hyn i pafuqishëm, i verbër, i udhëhequr si fëmijë i vogël nga të tjerët. E ka të qartë se nuk ka llojë me Krishtin dhe se para Tij dorëzimi është fitore, përvujtëria krenari, dobësia forcë. Derisa Sauli po luftonte me vetveten, Anania ishte i struktur dikur në tavan dhe dridhej nga tmerrin ndaj Saulit. Por, Jezusi e thirri Ananin dhe i tha: "Qohu dhe shko ne rrugë që quhet 'E drejtë' e në shtëpinë e Judës lype njeriun prej Tarsit që quhet Saul. Ai tani po thotë uratë (Vap 9, 11-12)." Kjo gjë i dukej Ananisë krejt e pabesueshme. A është e mundur që Sauli që ka bërë aq shumë të këqija në Jeruzalem tani të lutet? A e din ku po më dërgon? Kush mund t'i dali para? Dërgoje një tjetër, jo mua. "Shko - i përgjigji Zoti - sepse ai është vegla ime,

që unë e kam zgjedhur për ta bërë të njohur Emrin tim para popujve paganë, para mbretërve dhe para bijve të Izraelit. Jo po, unë vet do t'i tregoj se sa shumë do t'i duhet të pësojë për shkak të Emrit tim! (Vap 9, 15-16)" Mos ke frikë, deri tani ky ujë i tërbuar shëtiste rrugë e parrugë, kërcente gardhiqe dhe e dëmtonte grigjën time, ndërsa tani ka hyrë në rrugën 'E drejtë' dhe tani është shndërruar në një dele të butë e së shpejti do të bëhet një bari i mirë. Do e gesh të verbëruar, në lutje dhe agjërimit. Tash tri ditë gjendet si i vdekur. Thirrë përmasë pagëzimit në ngjallje! "Anania shko, hyri në shtëpi e, duke ia vënë duart, i tha: 'Vëlla Saul, Zotëria Jezus, që t'u dëftua në udhë kur ishte duke ardhur këtu, më dërgoi që ta rifitosh dritën e syve e të mbushesh me Shpirtin Shenjt (Vap 9, 17)." Ja, pra, ky është krishterimi! Anania

e dinte të kaluarën dhe të tashmen e Saulit, por, prapëseprapë, e pranoi armikun dhe kriminelin në radhët e veta dhe i shqiptoi fjalët e mrekullueshme: "Vëlla Saul, shiko!" Çka vlen të kesh sy dhe mendje të përsosur dhe të mos e shikosh Krishtin, Dritën e vërtetë dhe të amshuar?

Drita e Krishtit është një shndërrim e shpirtit, spastrim i mendjes dhe logjikës dhe shpëlarje e trurit. Kjo Dritë na përkujton errësirën dhe na ndihmon në fillimin e një jete të re, të cilën mund ta shikojmë vetëm me sy të pastër, me zemër të sinçertë, me jetë të vërtetshme, sepse gjithçka tjetër na verbëron dhe bllokton. Shën Pali ia dhuroi jetën Krishtit dhe nga kjo Dritë e përfitoi jetën e pasosur. Ai na mëson se kush don ta ndjekë këtë Dritë do të luftohet nga errësira, do të përndjeket nga injoranca, do të

urrehet nga epshet, do të dënohet nga xhelozia, do të vdesë nga urrejtja, por në fund do të ngjallet nga Ngjallja. Kështu, shën Pali duke e pranuar Krishtin nuk u bë tradhtar, por besimtar, duke humbur gjithçka për Të, fitoi vísare për qiell, duke përtëruar mundime në trup u forcua në shpirt, duke hedhur poshtë mësimet njerëzore u shndërrim me Shpirtin e Shenjtë, duke përqafuar Krishtin i ra grusht Djallit. Andaj, le të bëhet edhe për ne një udhërrëfyes! Le t'i forcojë të gjithë ata që sot përjetojnë të njëjtat vuajtje dhe përndjekje, për arsye se donë të përcaktohen për kulturë, traditë, jetë! Le të jetë ndihma e të gjithë njerëzve që përfundimisht të mund të dalin nga errësira dhe injoranca! Le t'i frymëzojë popujt që të kuptojnë se kthimi kah Krishti i ringjallur, Zot e njeri, nuk është tradhti, por detyrim

dhe ndërgjegjësim! Le t'ia nxjerr hirin popullit tonë në rizbulimin e vlerave ungjillore të predikuara nga vet ai paraardhësve tanë ilir, pa jetësimin e të cilave kurrë nuk do të mund të gëzojë kulturë, paqe, dashuri!

Përdërisa shqiptarët po kërkojnë ndihmë nga Perëndimi, dhuna po depërton fuqishëm në trevat dhe familjet tona që historikisht ishin fuqibeteja në mes të Dritës dhe Errësirës, ndërsa ne, jo për shkak të verbërisë, apo mosdijes, e vazhdojmë lutjen: O Zot, mos ua merr këtë për mëkat, dhe me paqe që i karakterizon të krishterët i drejtohem i çdo njeri me fjalët: "Vëlla Saul, shiko!", me qëllim për ta ndihmuar në shfëltimin e historinë dhe në njohjen e vlerave të krishterimit në trevat ilire.

-vijen-

Ese

Eutanazia e panënskruar

■ SHKRUAN:
Pal CANAJ

1. Në këtë botë flitet e përfillet për jetën e vdekjen. Mendohej e komentohet se çka i lidh jetën e vdekjen, ku është kufiri i ndarjes në mes tyre. Pyetje dhe nënpetje, dilema të shumta në mendjen dhe në kokat e njerëzve. Njeriu në pyetje të shumta dhe të ndryshme që i shtrton, përpjetet që të përgjigjet edhe për veten e tij. Në rastet kur përjetat logjike rezultojn shterp për këtë çështje, mendja i referohet metafizikës e kur metafizika spekulon, orientimi shkon drejt religjionit.

Eutanazia është temë diskutimi në shumë lëmi të jetës, si në religjion, etikë, mjekësi, filozofi, psikologji, jurisprudence e sfera të tjera. Në të gjitha këto lëmi eutanazia analizohet nga këndvështrime të ndryshme, por si përfundim mund të rezultojë se vullneti i individit ka të bëjë vetëm me përkushtimin ndaj jetës, e jo edhe me fillimin dhe fundin e saj. Mund të ketë njerëz dhe mund të kenë norma apo ligje që i thonë po eutanazisë, pra vdekjes së vullnetshme apo dhënies ndihmë për vdekjen fizike të njeriut. Por, vështirë të ndodhë që individit apo kolektivitetit të nënshkruajë vullnetshëm vdekjen e ndërgjegjjes dhe të përshpirtësisë.

2. Grupi i njerëzve, të cilët nuk ishin pajtuar me eutanazinë e ndërgjegjjes, kishin ardhur në vendin sakral për të dëshmuar ndjenjën e shpërsës së pahumbur dhe ruajtjen e dashurisë së përbotsme në plazmën e vetëqenies së tyre.

Për grupin e tillë njerëzish ishte një ditë e veçantë, dhe kjo ishte zgjedhja e tyre. Ishte një prej ditëve të Kryefestës, që historisë së njerëzimit rrënjësisht i dha një kuptim të ri, festë që ndau epokat, ku hyjnorja animoi në trajtën njerëzore. Njerëzit, në të tilla kremte pushojnë, kanë

nevojë për qetësi dhe rimarrje të vetvetes. Festat çmohen jo vetëm si ditë pushimi dhe gazmendit, por edhe si moment për vokacion dhe valorizimin e vlerave shpirtërore.

Dita e fundjavës, të vitit në përfundim, në figuracionin e saj sikur i ngjante gurrës që i kthehet shtratit të vjetër. Në këtë ditë, në vendndodhjen e tempullit, e zakonshmeja sikur ishte tej përmasave të saj. Kishin ardhur njerëz nga një vend jo edhe i largët, të cilët nuk ishin pajtuar me eutanazinë e ndërgjegjjes së identitetit dhe të vetëqenies së tyre. Ata dukeshin si të krehur në vetvete, po mjaft dinjitoz në vetëbesimin e tyre dhe me brumosje të theksuar shprehe.

Në vendin e simbolikës së filijimit, Prelati, me devocionin e dishepullit këtyre njerëzve, ua lexonte dhe komentonte Testamentin me rastin e rithadrit, të rigjetjes së vetvetes së tyre. Më pastaj ai vazhonte me fjalët e tij duke iu thënë: Ju që nuk e nënshkruat eutanazinë e ndërgjegjjes shpirtërore, nuk u zhbëd, prandaj ju jeni të gjallë dhe në plotësinë e vetvetes tuaj. Vëllai i përkushtuar i majeutikës shpirtërore, që qëndronte përballë tyre, i sfidoonte metaforat e oratorisë së ligjërit, duke iu drejtuar atyre: ju jeni të gjallë, ju jeni më të gjallë se të gjallët, sepse gjithmonë e patët ndjenjën e shpërsës së jetës në dashurinë e përbotsme.

Ata, të mendjet e tyre radhinin vargëzimin gjenealogjike të historisë, tek i pari i dyti, i treti... ndoshta edhe tek i katërti. Kujtonin toponimin e vendit të tyre, toponimin interesant për gjeografinë e vendit, që simbolizonte një karakteristike të veçantë të antropologjisë së njeriut, organin e të degjuarit, receptorin e fjalës. Fjala dhe Dheu, të kanonizuar në shkrimin biblik, sikur shpreheshin me tërë profecinë e tyre edhe në këtë rast.

Të huajt që kishin ardhur prej kohësh në këtë vend, e që ishin

krejt ndryshe nga anasit, e kuptuan këtë sintetizim në mes fjalës dhe dheut. Kjo i bëri shumë kurreshtarë dhe filluan të mendojnë, se këta që kanë veshë të theksuar, kanë edhe timpan të fortë. Hartuesit e eutanazisë së ndërgjegjjes e kishin nahuat këtë për mrekulli. Timpani dhe daulla shkojnë bashkë, pra duhet rrahur daullen për ta valëzuar zërin fuqishëm në timpanin e veshit. Dhe një ditë vendasve, në jetën e mekur të zëzonave të kohës, u erdh në timpanin e uturimës së daullës. Më pastaj ishte degjuar edhe fjala prej një urdhri kërcënues: ore njerëz, ju duhet që ta nënshkruani eutanazinë e vetëqenies suaj, e nëse jo, ne do t'ua firmosim.

Atyre u kujtohej rrëfimi i degjuar për daullen kur kishte buçitur, kur njerëz të huaj së bashku me ndonjë të tharuar me sy të çakërdisur kishin lëshuar britmat: ju jeni të vdekur, nënshkruajeni eutanazinë. Ju duhet ta vdisni vetveten, ju duhet të zbeheni për t'u bërë si të jetërë. Ne vetëm kemi ardhur për t'ua lehtësuar vuajtjet. Ata që nuk do të jenë në përngjasimin tonë, do t'i gërryjmë nga brenda dhe do t'i shpërlajmë nga mendësia e kontinentit tuaj të matufosur. Paradigma e mënyrës sonë i përgjigjet sentencës, se në fillim do të na respektoni nga forca e më pastaj nga detyrimi e krejt në fund nga dashuria. Koha do të tregojë se do të ushqehemi me ndjenjën e dashurisë ndaj nesh. Vetëm kokëkrisurit mund të mendojnë ndryshe dhe ta vënë në dyshim këtë. Ju nuk jeni mrekullia vetë, ne jemi mrekullia e kësaj bote. Madhështia jonë do ta përllaje çdo pengesë.

Sa keq që ju nuk e pranoi mëshirën tonë, ajo është e madhe, kështu thotë dhe i përndritshmi ynë. Ai është i mëshirshëm, prandaj donë që t'ua lehtësojë vdekjen, pa dhembeje dhe vuajtje. Nën ritmin e tingujve të daullës vdekja është e lehtë! Dhe daulla, e shoqëruar me zërin e tellallit vazhdon të kumbonte fuqishëm.

Ata nuk e nënshkruan eutanazinë e ndërgjegjjes shpirtërore, ata jetonin të hermetizuar me jetën. I mbyllën portat dhe filluan ta ndryjnë jetën, mbanin çelësat dhe vetëm për njerëzit e zemrës i hapnin. I mbyllnin ato posa hynin të tillët. Vetëm në të atilla raste, kur besa i shoqëronte me tërë rigorozitetin e saj, flitej për jetën, kremtohej dhe nën dritën e mekur të vravashkës ritualit mbëltoheshin për të mos i vishkur heshitja.

Sa herë kishin vdekje, ktheheshin nga varrezat me dyzim mendimesh për njeriun e humbur dhe epitaftin e munguar në simbolin e vuajtjeve. Në gazmendet sikur u mungonin baladat e hareshme. Si mund të gëzohehin njerëzit me kumtin e fermanit të vdekjes, kur rituali bëhej prapë me daulle që shkaktonë ndjenja të përziera. E daulla, edhe në raste të gëzimit, sikur ngacmonte ndjenjën njerëzore në rikujtim te kumtit.

Në dialogët e breznive, kur flasin të rinjtë, të moshuarit thoshin: ju sikur nuk flisni me jetën, ju sikur flisni me tjetër botë. Nëse flisni me jetën, ju duhet ta njihni atë, ajo është tek ju, humlutojeni, gjejeni. Thelbi i jetës nuk është larg, por afërsia sikur ikën, ajo duhet nxënë se përndryshe na jemi fajtorë. Simbolikën e themeleve mund ta gjeni edhe nën çatitë e ngrehinave. Por nuk mjafton vetëm kaq; atë duhet gjetur tek vetvetja. Nuk mund të jeni të vetëm, në ecjen e orientuar do të takoheni me vertikalen e jetës, me simbolin e dashurisë.

Por, kjo gjë një kohë ndodhi, ata e nxënë jetën, i folën asaj me çiltërsinë e shpirtit. Ata me thelbin e zemrës i rrëfyan Shenjtores së Këshillit Mirë, për gjakimin e besnikërisë së tyre dhe pikëllimin për rrëfimin e Gjencanos dhe për gëzimin e gjetjes në këtë vend. Të bindur në vetveten, morën hirin dhe uratën, dhe si amanet i të parëve në pafundësinë e shpërsës,

synimin e eutanazisë së ndërgjegjjes përfundimisht e shpërfillën.

3. Njerëzit e kësaj sëmbebllyre, devotshëm i dhanë përgjigjeje ndërgjegjjes së tyre të vullnetit njerëzore. Konceptin e teardhmes ndërtojnë në simbiozën e koherencës dhe vlerat e jetës i akceptojnë në kufijt e logjikës përmbajtësore. Etapave të historisë së jetës domethënëse ua gjejnë përmes kthjelltësisë racionale. Dhembjet e papërbalueshme të krajatave njerëzore vlerësimit absurd të ligësisë asnjëherë nuk iu nënshtruan, ngase në aspektin eshatologjik, etnia ruajti shumësin e simboleve të domethënies së jetës. Ata jetën ndërtojnë në pleksion e dashurisë vëllazërore, sepse vetëm si të tillë ndër motet sfidonin zëzonat e kohërave. Në vetvete nuk mbartin ndjenjën e tëhuajturit ndaj të tjerëve, ashtu siç nuk ndëjnë vetën tëhuajë, vetëm dashuri ngjizin në koloritin e jetës.

Të gjithë shkelësit e huajt, në këtë vend, anticiponin përmbysjen e virtyteve të lashëtisë së shekujve. Nga intuita e anashe hetoheshin hullitë e së keqes, dhe të gjitha hilet nga jeta përvojësore. Të vëmendshëm ndaj qëllimeve troshitëse, tërësia e entitetit ruhej si aureolë shenjtërie. Atyre, shëmbëlltyrën e ndjenjës ndërvallazërore në shemëri askush s'arriti t'ua shndërronte. Në vazhdimësinë e jetës, forconin virtytet e fisme të vëllazërimit së gjaku, bifurkacionin e pykëzimeve të qëllimshme unifikonin më ndjenja dashurie, të amësisë së tokës. Ne rrugëtimin e stuhishëm unifikonin mendimet e psikologjisë kolektive për ruajtjen e substancës tërësisht përmbajtësore. Në të gjitha furtnat, kushtim të përbashkët patën dashurinë ndaj trullait të etërve. Të tillë në këtë univers çmohen për tolerancën, pa stërholime teorike, por me jetën e natyrshme, të mendësisë së fisme.

Klinë, dhjetor, 2008

Thirrja e Moisiut dhe e Marisë – thirrja jonë

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Dalja nga robëria egiptiane e Popullit të Zotit, Izraelit, historikisht ka ndodhur në shekullin XII para Krishtit, dhe është një ngjarje shumë e rëndësishme, praktikisht fillimi i formimit të këtij populli të zgjedhur prej Zotit. Kjo përvojë e "pashkëve", daljes apo kalimit prej robërisë në liri, prej territ në dritë, prej vdekjes në jetë, ishte kujtimi i fuqishëm historik i çdo hebreut në çfarëdo vështirësi të jetës dhe frymëzim i pashtershëm për përballimin dhe zgjidhjen e rrethanave të ndryshme jetësore.

Ky kujtim nuk ishte vetëm kthim në të kaluarën, apo regresion në histori, por jepte edhe më tepër fuqi për të tashmen dhe ishte profetizim, paralajmërim, projektim për ardhmërinë në të mirë të mbarë njerëzimit, sepse Hyji kishte ndërhyrë në histori, ishte bërë histori, ndërsa Moisiu pati rol mjaft të rëndësishëm, vendimtar e personal, por edhe për popullin e tij.

"Kurtha" e parë e Zotit në Malin Horeb për Moisiun ishte kureshtja, pamja e pakuqteshme dhe e pashpjegueshme e një kaçube të jashtëzakonshme.

"Kaçuba ishte ndezur flakë, por nuk digjej" (Dal 3, 1).

Mu për këtë Moisiu lëvizti, eci, u afrua për të parë dhe kuptuar çka po ndodhte me atë kaçubë.

Moisiu mendoi kështu:

"Po afrohem të shoh këtë dukuri të madhe: pse nuk digjet kaçuba?" (Dal 3, 3)

Flaka, zjarri, kaçuba, Sinai janë simbolet e zbulimit të Hyjit, shenjat e jashtme të pranisë së tij në mesin e popullit. Zjarri ngroh, ndriçon, pastro, kullon, është i fortë, i rrezikshëm, i përjetshëm, sinonim i pranisë së Hyjit, fuqi, energji, jetë...

Pasi që afruar Moisiu për ta parë kaçubën e çuditshme, dëgjoi një zë që i tha kështu:

"Moisi, o Moisi!" (Dal 3, 4)

Ishte ftesë krejt personale dhe me emër, pra, nga Dikush që e njohte atë fare mirë dhe kishte një pors për të.

Moisiu u përgjigj kështu:

"Urdhëro!" (Dal 3, 4)

që me fjalë tjera domethënë fol, po të dëgjosh, por edhe kush je ti dhe çka kërkon prej meje?

Veprimet paraprake që Hyji i kërkonte Moisiut ishin këto:

"Mos u afro këtu! Hiqi të mbathurat prej këmbëve të tua, sepse vendi në të cilin qëndron, është tokë e shenjtë!" (Dal 3, 5)

(Nga kjo ngjarje biblike rrjedh tradita islamike për t'u zbatuar në xhami).

Në kaçubën e ndezur shumë etër të Kishës, si dhe tradita e krishterë, kanë parë dhe vlerësuar virgjërinë e Marisë si dhe plleshmërinë e saj hyjnore, lindjen e Jezu Krishtit, Shëlbuesit të mbarë njerëzimit.

Shën Gregori i Nisës ndër të tjera shkruan kështu:

"Ajo që parafytyrohet në kaçubën e ndezur që zbuluar në misterin e Virgjërës. Sikurse në kaçubën që ndezet, por nuk digjet, kështu Virgjëra lindi Dritën, por pa e prishur virgjërinë e saj..."

Edhe Maria, motra e Aronit, ishte ajo që iu printe grave në kalimin e detit. Ja dëshmia biblike:

"Atëherë Maria profeteshë, motra e Aronit, mori darjen në dorën e vet; pastaj dolën të gjitha gratë me dajra, e filloi vallja!"

Maria po i printe këngës:
"Le t'i këndojmë Zotit, sepse mrekullisht ngadhënjëu: kalë e kalorës plandosi në fund të detit!" (Dal 15, 20-21)

Këtu nuk është fjala vetëm për ndonjë ngjarje të përkohshme, por paralajmërohet ndërhyrja e Hyjit si Shëlbues, Shpërblyes, Çlirimtar nëpërmjet Virgjërës Mari, Nënës së tij, e cila do t'i fundosë në fund të detit robëritë tona, mëkatin, vdekjen, Djallin.

fit, e pranishme në kryqëzimin e Jezusit dhe në varrin e zbrazët (krh. Gjn 19, 25);

Maria, gruaja e Kleofës (krh. Gjn 19, 25)

Maria, nëna e Gjonit, te e cila që strehuan Pjetri pas çlirimit të mrekullueshëm nga burgu (krh. Vap 12, 12);

dhe Maria e Romës, të cilën e përmend dhe e lavdëron Pali (krh. Rom 16, 16).

Në gjuhën kanese Maria domethënë e ngritur, e lartësuar, e nderuar, e dalluar, edhe pse Virgjëra Mari e mbante veten vetëm si shërbëtore të Hyjit, sepse ai kishte bërë vepra të mëdha në të (krh. Lk 1, 27).

Hyji që iu dëftua Moisiut nga kaçuba, nëpërmjet Virgjërës Mari u bë Njeri, vëllai ynë, për

"Unë jam shërbëtoria e Zotit: Më ndodhte siç the ti!" (Lk 1, 38).

Thirrja e ngjashme i drejtohet çdo njeriu me një ftesë të trefish-të:

në jetë - nëpërmjet lindjes; në fe - nëpërmjet pagëzimit; në gosti dhe në dashuri - nëpërmjet Eukaristisë.

Kaçuba që ndizet e nuk digjet është Eukaristia, prania e Jezu Krishtit dhe dëshira e tij për të fisnikëruar dhe ndezur zemrat tona me flakën e dashurisë, për ta ndërruar jetën tonë.

në dëshmi - nëpërmjet jetës së krishterë;

në pavdekësi, në shëlbimin e amshur - nëpërmjet jetës së pasosur.

Zoti e ftoi Moisiun që të afrohej, të zbathej, të shkonte te populli i zgjedhur për t'ua zbuluar Hyjin, emrin e tij, Unë jam ai që jam (krh. Dal 3, 13-15), si dhe planin e tij për çlirim nga robëria egiptiane (krh. Dal 3, 16-22).

Zbatja domethënë përvujtërimi, pastrimi nga mëkati, robëria, si dhe afërsia, pranimi dhe bashkëpunimi me Hyjin.

Virgjëra Mari ftohet që të "zbatet", të hiqte dorë prej vetes, planeve jetësore, për ta pranuar dhe zbatuar planin e Zotit, mishërimin e Jezu Krishtit, si hapi i parë i shëlbimit.

Çdo i krishterë është i ftuar prej Zotit që të dalë prej "lekurës së vet", të lirohet nga egoizmi dhe egocentrizmi, mëkati, për ta pranuar dhe zbatuar planin e Zotit, për ta tejkaluar vetveten me hirin e tij, për t'i shpallur veprat e Zotit me jetën dhe dëshminë e krishterë.

Moisiu e pranoi ftesën e Hyjit, dhe Zoti nëpërmjet tij e udhëhoqi popullin nëpër shkretëtirë, Detin e Kuq, drejtë lirisë, tokës së premtuar.

Virgjëra Mari e pranoi dhe e plotësoi tërësisht planin e shëlbimit me shumë fe, shpresë dhe dashuri.

Shqyrtim për ne:

E unë, ti, ne, ku jemi, në cilën "fazë" të ftesës dhe të dërgimit?

Sa jemi të gatshëm t'i përgjigjemi ftesave të Zotit në përditshmërinë tonë?

A e njohim dhe pranojmë ne planin e shëlbimit për veten tonë, për të tjerët, dhe sa këtë e dëshmojmë me jetë?

Moisiu dhe Maria e plotësuan në tërësi planin e Zotit, dhe atë ua kumtuam, zbuluan edhe të tjerëve, si mision, dërgim. E ne?



“Shën Gregori i Nisës ndër të tjera shkruan kështu: “Ajo që parafytyrohet në kaçubën e ndezur që zbuluar në misterin e Virgjërës. Sikurse në kaçubën që ndezet, por nuk digjet, kështu Virgjëra lindi Dritën, por pa e prishur virgjërinë e saj...”

Prokleo, zëvendësi i Nestorit, diku në vitin 428 ose 429 e përdori terminin THEOTOKOS, Nëna e Hyjit - për Virgjëren Mari, duke i paraprirë kështu koncilin të Efezit (431), në të cilin ne na zbulohet dhe na dhurohet Virgjëra Mari si Hyjindëse, ndërsa Zoti me ne - EMANUELL, Jezu Krishti, si kaçuba nëpërmjet të cilës Hyji iu kishte zbuluar Moisiut.

Emri Maria ishte mjaft i përgjithshëm në popullin e izraelit. Në Besëlidhjen e Re përmendet 6 gra me këtë emër:

Maria, motra e Lazrit dhe e Martes (krh. Lk 10, 38-42)

Maria Magdalenë, nga e cila Jezusi kishte dëbuar shtatë djaj, por edhe që ishte dëshmitarja e parë e ngjalljes së Jezu Krishtit (krh. Lk 8, 2; Gjn 20, 11-18)

Maria, nëna e Jakobit dhe Ze-

t'u zbuluar dhe dhuruar mbarë botës si Shëlbues.

Moisiut i thotë: zbatu, sepse vendi është i shenjtë, ndërsa Marisë, nëpërmjet engjëllit Gabriel i thotë se Zoti do të mishërohet në Të, për virtyt të Shpirtit Shenjt, sepse "s'ka gjë të pamundshme për Hyjin" (Lk 1, 37).

Përgjigja e Marisë ishte hapja, gatishmëria dhe bashkëpunimi i saj i plotë me Zotin:

ABC-ja e familjes (III)

■ PËRGATITI:
P. Shtjefën Dodes J

Për çdo shkronjë të alfabetit po ju sjellim disa mendime nxitëse për të reflektuar për një jetë më të lumtur

P – para; Q – qeshja; R – respekti; Rr – rritja (puberteti); S – sfera private; Sh – shëndeti; T – tabutë (ndalimet); Th – thashethemet; U – unë-martesa; V – vëllezërit e motrat; X/Y/Z – zgjedhja e lirë; Zh – zhvillimi.

P – para

Në shumë familje lindin konfliktet për shkak të parave. Nganjëherë për shkak se ato duhen kursyer, mirëpo shpesh herë edhe për shkak se në familje përjetohen qëndrime të ndryshme në lidhje me paranë. Sidoqoftë, tema e parës nuk do të duhej të ishte tabu (që ndalohej të flitet për të). Edhe fëmijët duhet të jenë të informuar për situatën e njëmendtë financiare të familjes, në mënyrë që ta mësojnë ndaj kësaj një qasje reale dhe të përgjegjshme. Çdo anëtar i familjes, me çdo kusht do të duhej të kishte në dispozicion një shumë të caktuar parash në mënyrë krejt të pavarur, pa iu përzier kush. Sasia e shumës natyrisht është çështje e bisedimit dhe e varur nga buxheti juaj familjar – dhe në të vërtetë nuk është aq e rëndësishme sa është ajo e lartë. Shumë më e rëndësishme është që me ato të mund të bëhet ajo çfarë dëshirohet.

Q – qeshja

Të gjithë ju do të duhej të qesheni sa më shumë! Sajoni një lojë qesharake. Tregoni ngjarje dhe histori gazmore. Shikoni së bashku komedi dhe filma gazmorë. Qeshni së bashku mbi vetveten dhe mbi ju si familje. Mos e përqeshni kurrë vetveten, por gjithmonë qeshni me të tjerët. Qeshja e përbashkët bashkon dhe bën mirë.

R – respekti

Respekti është shumë i rëndësishëm për një atmosferë të dashur dhe që nxit përparim. Mirëpo, pikërisht shpesh herë e kemi të vështirë të tregojmë respekt ndaj njerëzve me të cilët jetojmë afër së bashku. Atëherë shumë shpejt e marrim si të vetëkuptueshme dhe harrojmë se çdonjëri në familje e ka personalitetin e vet me interesat, njetet, ndjenjat, dëshirat dhe nevojat e veta. Mos u përpasni me ndjenjat e të dashurve Tuaj. Bëni gjithmonë një hap simbolik anash dhe shikoni të dashurit Tuaj në një distancë të caktuar. Kushtoni vëmendjen dhe respektoni njerëzit me të cilët jetoni – ata janë të denjë për këtë dhe ashtu si ju silleni ndaj të tjerëve, ashtu do të sillen edhe ata ndaj jush.

Rr – rritja (puberteti)

Puberteti i fëmijëve për të gjithë pjesëmarrësit është një fazë e vështirë dhe paraqet për shumë familje një fazë prove të vërtetë. Fëmijët

ndryshojnë – shpesh herë jo edhe për qejfin e prindërve – dhe as vetë nuk e dinë se ku e kanë vendin. Pakënaqësia, lëkundjet e akordimit emocional, rebelimi i hapur apo i fshehur – të gjitha këto kërkojnë shumë duresë, fuqi dhe dashuri të anëtarëve të familjes. Dhe pikërisht këtu fjalë është që ata që janë në rritje e sipër t'i duam ashtu siç janë – me budallallëqet dhe gabimet që i bëjnë në rrethana dhe me gjendjen dhe atmosferën e padurueshme të tyre shpirtërore. Njerëzit në pubertet kërkojnë mbështetje dhe orientim dhe është shumë me rëndësi që këtë ta gjejnë në familje.

S – sfera private

Edhe në familje në të cilën të gjithë pjesëmarrësit jetojnë në një hapësirë shumë të ngushtë është me rëndësi të tregohet kujdes që çdonjëri të ketë të drejtën për sferën e tij private. Kjo vlen edhe për më të vegjlit. Ideale do të ishte nëse çdo anëtar i familjes e ka në dispozicion dhomën e vet. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë të paktën do të duhej të ketë një hapësirë të kufizuar dhe çdo fëmijë të mund të ftonte një "sënduk të fshehur" (mundësisht të mund të mbyllet) apo diçka të ngjashme. Si prindër, respektoni domosdo fshehtësitë e vogla të fëmijës Tuaj. Mos ia lexoni kurrë p.sh. ditarin e fëmijës Tuaj. Një thyerje e tillë e besimit zor se do të mund të ndreqej sërish.

Sh – shëndeti (terapia familjare)

Shëndetin dhe sëmundjen duhet vështruar në kontekstin e marrëdhënieve thelbësore të jetës, ndër të cilat rol të rëndësishëm kanë edhe marrëdhëniet bashkëshortore dhe brendafamiljare. Cilësia e tyre ka ndikim afatgjatë në shëndetin dhe sëmundjen e çifteve bashkëshortore apo anëtarëve të familjes. Për shkak të orientimit individual medicina është e verbër për ndikimet e marrëdhënieve ndërmjetëzore për shëndetin dhe sëmundjen e të sëmurëve të saj. Kërkimet psikoneuroimunologjike tregojnë kujdes për ndikimin e cilësisë së marrëdhënieve ndërmjetëzore që janë të rëndësishme për jetën.

T – tabutë (ndalimet)

Gati në çdo familje ekzistojnë tabu-temat. Kjo mund të jetë për shembull një fshehtësi e mirënjohur familjare, tema apo çështje të përshkuara me frikë, që hedhen poshtë dhe mohohen. Tabutë të

shumtën e rasteve nuk u bëjnë mirë pjesëmarrësve dhe para së gjithash fëmijëve ua vështirësojnë jetën nëse disa tema nuk preken. Ndalimi natyrisht e bën këtë gjë veçanërisht interesante. Rishqyrtoni gjithmonë ndonjë tabu ekzistues. Vetëm pse deri më tash ka qenë diçka e tabuizuar, nuk është e thënë që ajo patjetër të mbetet e tillë edhe sot. Nganjëherë bën mirë më në fund të mund të flitet për të.

Th – thashethemet (i ri – i vjetër)

Në familje anëtarët ia kanë frikën bisedës së sinqertë, të hapur për çështjet kyçe të marrëdhënieve të tyre, prandaj më lehtë i marrin nëpër gojë të tjerët. I shmangen bisedimi të sinqertë jo për shkak të frikës nga tjetri, por para së gjithash për shkak frikës nga të shprehurit të qartë të vetvetes. Nuk i frikësohen tjetrit, por njohjes me të thellë të vetvetes dhe kësaj në marrëdhënien e përbashkët. Pajoja e kësaj frike është largimi gjithnjë e më i madh në mes veti jo vetëm në nivelin e komunikimit, por edhe në ato të tjera të jetës familjare, siç është ai emocional, seksual, njerëzor dhe intim.

"I ri dhe i vjetër": në një familje jetojnë të paktën dy, nganjëherë tre dhe në disa raste madje katër gjenerata së bashku. Marrëveshja në mes gjeneratave nuk është gjithmonë e thjeshtë, mirëpo mund të jetë pasuruese. Në atë rast është me rëndësi që të të dyja anët të ekzistojnë një çiltëri për gjeneratën tjetër, sepse të dyja anët mund të mësojnë prej njëri-tjetrit. Nëse pra ju bëni pjesë në gjeneratën e vjetër, atëherë mos e luani vetëm kryet për rininë e sodit, por provoni t'i kuptoni se çka domethënë të jesh i ri/e re në kohët e sodit. Pyetni, interesohuni dhe jini të hapur. Edhe për të rinjtë Tuaj: shfrytëzoni shansin të përfitonin nga dija dhe përvoja e gjeneratave të vjetra. Lejoni të rrefëni si ka qenë jeta përpara. Fotoalbumet ndër të tjera janë ndërmjetësues të mrekullueshëm të gjeneratave – rriparojeni një herë një së bashku dhe rrefëni njëri-tjetrit historitë në foto-grafi.

U – "unë-martesa"

Cilësia e jetës familjare është ngushtë e lidhur me cilësinë e jetës bashkëshortore, të prindërve. Në unë-martesa dominojnë unë-porositë, që tërheqin dhe e mirëfillin çiftin bashkëshortor dhe nxisin në bashkëpunim. Ato i shërbejnë

zbulimit të njëri-tjetrit, jo fshehjes. Përveç kësaj te to gjithmonë është i pranishëm edhe dëgjimi aktiv dhe pranimi i njëri-tjetrit. Çiftet bashkëshortore në unë-porosi i komunikojnë qëndrimet, mendimet dhe ndjenjat personale, përgjigjen në dëshirat dhe lutjet e partnerit bashkëshortor, ndalojnë probleme dhe vështirësi të mundshme në lidhje me sjelljen e tyre të dyanshme. Unë-porositë luajnë rol të rëndësishëm edhe në shprehjen e ndërsjellë të lavdërimeve dhe komplimenteve. Pa to është e paimagjinueshme shprehja e njëri-tjetrit për veten dhe tregimi i përjetimit të brendshëm të situatës martesore – pa të cilën gjë nuk ka intimitet të sinqertë martesore.

Në ti-martesa dominojnë ti-porositë, që kundërshtojnë dhe kërcejnë, nxisin refuzimin, mbrojtjen apo kundërsulmin. Ato u shërbejnë për gjykim apo vlerësim negativ të njëri-tjetrit. Nxisin ndjenjen e fajit. Nxisin kundërshtimin e ndryshimit.

Në ne-martesa mbizotërojnë ne-porositë. Ato në të vërtetë janë unë-porosi dhe ti-porosi të zbutura dhe të shkapërdërdhura. Kur dëshirojmë ta fshehim ambivalencën tonë në shprehjen lidhur me vetveten dhe ndjenjat, dyshimet dhe nevojat, dëshirat dhe planet, mendimet dhe vlerësimet tona, atëherë në vend të unë-porositë përdorim ne-porositë, në të cilat shprehja direkte dhe autorizimi i porositë është i fshehur dhe i paqartë.

V – vëllezërit e motrat

Në shumë vende të perëndimit për shumë familje nuk është njëjtë se a kanë vetëm një apo më shumë fëmijë. Vendimi për të pasur më mirë një fëmijë konstatohet duke treguar se konstelacionet shumë vëllezër e motra përveç të mirave kanë edhe të meta. Këtu rol luajnë një numër i madh faktorësh: ndjeshmëria e trupit e nënës, koha, planifikimi profesional, para, vendi, fuqia dhe energjia. Në çdo rast duhet thënë se vëllezërit dhe motrat e pasurojnë jetën e një fëmije dhe në atë rast prindërit nuk qëndrojnë të vetmuar në prishmëritë e personave të edukimit.

X/Y/Z – zgjedhja e lirë

Familjen mund ta zgjedhim për vetëvetëm kushmishit. Ju lindni në një familje, martoheni në një tjetër dhe pastaj e krijoni vetë një tjetër. Dhe gjithmonë do të ketë anëtarë familjar me të cilët nuk do të mund të merreni vesh. Këtu keni dy mundësi: t'i sqaroni konfliktet dhe të punoni së bashku në zgjidhjen e tyre volitshëm për të gjithë – nëse duhet me ndihmë profesionale të

një terapisti, ose ta shmangni kontaktin. E para është me rëndësi, para së gjithash me vështirësitë me prindërit dhe fëmijët Tuaj, pra me të afërmit Tuja shumë të afërt, që Ju i çmoni shumë, sepse fërkimet e shumëzgjatura me persona krijojnë ngarkesë të madhe.

Zh – zhvillimi (përparimi)

Martesa dhe familja nuk mund dhe nuk guxojnë të jetojnë prej ideve të vjetra dhe shprehive të grisura nga përdorimi. Kjo është molla shërrë për shumë familje të sotshme. Martesa shpesh herë po shndërrohet në "muze me figura prej dylli" në të cilat zotëron heshtja, pastërtia, paqja, mirëpo asgjë nuk ndodhë dhe nuk lëviz. Figurat heshtin dhe shikojnë vetëm njëra përkaj tjetrës. Gjithçka është e njëjtë, prej kohës e njohur, e pandryshueshme, e vjetër, e amshuar. Një familje e tillë zakonisht pastrohet, mirëpo nuk ndryshon, rregullohet, mirëpo nuk lëviz. Familjarët i sundojnë rregullat pa përgjigje, principet pa përshatje, detyrimet pa lirinë e zgjedhjes, shprehjet pa mundësi ndryshimi, ritualet pa spontanitet, sjellja e mirë pa jetë, seksualiteti në martesë për shkak detyrës pa dashuri, fraza pa të qenit autentik, të puthura pa pasion, prekje pa ndjeshmëri, diskutime pa dialogje, intimitet formal pa tërheqje. Nga një martesë apo familje e tillë njeriu ikën. Në të nuk mund të qëndrohet. Në të vdiset dalëngadalë.

Rrugëdalja është çiltëria e anëtarëve për të eksperimentuar me ide të reja, për një dialog të njëmendtë për situatën familjare, për kërkimin e përbashkët të ideve ende të pasfrytëzuara dhe gjetjen e zgjidhjeve origjinale. Është gabim të mendohet se kjo është e mundur vetëm me partner të ri. Nuk shpëton partneri i ri por idetë e reja, dialogu i njëmendtë, kërkimi i zgjidhjeve të reja me të njëjtin partner. Nëse e ndryshojmë vetëm partnerin, shumë shpejt do të përsëritet ajo prej të cilës kemi ikur, të zhgënjyer duke e bërë reprizën e të njëjtës martesë në të cilën më nuk kemi mundur të qëndrojmë, sepse problemi nuk është në partnerin, por para së gjithash në ne – bashkë me lidhjen e re do ta sillnim edhe veten tonë të pandryshuar.

Pra t'i kthehemi vetvetes, martesës dhe familjes sonë!

Literatura e përdorur:

- Tania Konnerth, "Das kleine ABC der Familie"
- Pavao Brajša, "Mali branci sarajeti"

Të rinjtë dhe morali

■ SHKRUAN:

Don Matteo Di FIORE

Ky shkrim na ballafaqon në mënyrë të përgjithshme raportet në mes të rinjve dhe moralit të tyre.

Do të hedhim një sy mbi të rinjtë katolikë, do ta shohim Krishtin tonë dhe do të flasim për moralin simbas urdhërimeve të Zotit dhe mësimin e Ungjillit.

Është vetë Krishti i Ungjijve pikëqëndrimi i veprimtarisë morale, të zgjedhjeve tona etike dhe të Kishës, porsì Mësuesja e jonë dhe Nënë e jonë. Shpirti Shenjtë, dhuruesi i jetës, i Cili vepron në zemrat tona dhe të çdo njeriu është burimi i çdo forme të së mirës të pranishme në në dhe për rreth nesh. Shpirti Shenjtë pra është burimi i çdo pozitiviteti moral. Në ditët e kaluara, Papa Benedikti i XVI-të, në Afrikë na dhuroi leksione të mëdha mbi dëshnimin e zgjedhjeve tona etike ku besimtarët dhe mbarë popujt duhet të veprojnë për një zhvillim të plotë dhe integral të çdo njeriu dhe për të gjithë popujt. Shenjtërit, me mënyrën e tyre e të qenit besimtarë, na kanë dhënë shembull si të sillmë dhe si të veprojmë duke ecur kah plotësimi dhe realizimi i jetës tonë.

Shtrojmë pyetjen: në çka bazohet jeta e jonë morale? Cilat janë aspektet etike, sfidat morale të cilat besimtari duhet t'i ballafaqojë për të dhënë një dëshmi të lirisë së vërtetë dhe për pjesëmarrje në zhvillimin dhe progresin sipas jetës të krishterë?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve, kemi zgjedhë këtë metodë punimi dhe përgjigje, duke involvuar disa meshatarë, disa motra të nderit dhe disa të rinj katolikë me disa pyetje, të cilat kanë të bëjnë me temën aktuale, dhe këshu takimi i çdo besimtari takohet me këto dhe është i thirrur që të përgjigjet duke i bërë të tijat ndjenjat, qëndrimet dhe sjelljet e vet Krishtit dhe Ungjillit të Tij. Secili nga ne, edhe lexuesit, mund të konfrontohet dhe ballafaqohet me këto pyetje dhe mund të bënë pasuri në ecjen e tij shpirtërore duke lexuar dhe duke u ballafaquar me të tjerët.

Ja pra tani pyetjet dhe disa nga përgjigjet...

1. Kosova ka arritur pavarësinë e saj dhe po ecën drejt ndërtimit të realitetit të popullit dhe të Shtetit:

1a. Çfarë do të thotë sot predikimi dhe dëshmia e Ungjillit në kohën tonë, në kulturën shqiptare në Kosovë dhe në brendi të Kishës Katolike në Kosovë?

1a) Për ne nevojitet vetëdija e dyfishtë, historike dhe aktuale, për ta njohur historinë, traditën dhe krishterimin tonë dymijëvjeçar; aktuale, për t'u frymëzuar për të sotmen me përgjegjësi dhe me dashuri, për ne dhe për rrethin tonë.

Sot Kosova ka nevojë shumë për ungjillëzim. Shumë prej bashkëkohësve tanë nuk na njohin dhe nuk e dinë misionin tonë si të kushtuar Zotit e as të besimtarëve tanë. Janë të informuar gabim se ne jemi ndoshta kundërshtarë të tyre, ose edhe të njëzëmit, të përparimit, etj. Shoh se këtë e bëjnë për arsye se nuk janë të informuar mjaft, ose janë të informuar rrethshëm.

1b. Çfarë do të thotë që duhet të ndërveprojmë me ata që kanë mendim tjetër prej nesh dhe të mbajmë një vetëdije kritike në kërkimin e së vërtetës dhe të së mirës sipas ndërgjegjes?

1b) E mira është gjithnjë e për-bashkë, pra, nevojitet kultivimi i kulturës së takimit, afrit, bashkimit i mbështetur në të vërtetën dhe në dashuri.

Të jemi gjithmonë në diskriminim të krabhasimit, të dialogut duke evituar çdo lloj provokimi apo nënçmimi, si personal si institucional.

Ta kuptojmë se ajo që është e dalluar nga ne, jo gjithmonë është e dëshme.

Të kemi mundësi frymëzimi dhe shoqërimi, porsì atë shpirtërorë, të gjithë të rinjtë, sepse tani më shumë se gjithmonë kanë nevojë për shoqërimin tonë.

2. Kisha Katolike që është në Kosovë do të ballafaqohet me shumë sfida, kërkese apo pretendime për ndryshime:

2a. Çfarë do të thotë për ju të jetosh kulturën e dialogut me ata që janë ndryshe nga ne, kulturën e hulumtimit, e njohjes dhe e hapjes ndërfaqetare dhe ndëretnike?

2a) Ndryshe nuk domethënë kundërshtarë, armike, por krijimi i bashkimit në dallim, sepse dialogu ndërfaqetare dhe ndëretnik është rast, mundësi begatimi, bashkëpunimi dhe bashkëjetese, për të ikur konfrontimin, konfliktin, urrejtjen...

2b. Çfarë mendon se a nevojitet në Kishë një rritje të përshtirës, përkrahjes dhe ndihmesës e bashkëveprimt?

2b) Pa përshtirëri, jetë të krishterë, s'ka as dëshmi, mundësi bashkëpunimi dhe bashkëjetese me Zotin dhe me të afërmin. Së pari lypset të jemi të krishterë, pastaj të jetojmë dhe veprojmë si të tillë.

Duhet të vetëdijesohemi se puna në vetmi nuk është e mjaftueshme; puna vetëm nuk preferohen në kohët e sotme. Por, tani ka ardhur koha të jetojmë dhe të bashkëveprojmë në EQUIPE (Ekip), në GRUP, në SHOQATË, në VËLLAZËRI, në BASHKËSI, në RRJET; kur veprojme së bashku, vetëm atëherë do të jemi shumë të BESUESHËM dhe DËSHMITARË të vërtetë.

3. Papa pak ditësh Papa në Afrikë, ka dënuar gjenocidet dhe

shumë luftëra të harruara nga informacionet publike; Rusia është duke e përforduar armatimin e saj të luftës; në botë ka kanosje nukleare:

3a. Çfarë paraqet për ty paqja dhe mosdhuna ungjillore?

3a) Mosdhuna apo strategjia paqësore dhe jodhunore është zbatuar në Kosovë me dekada dhe ka dëshmuar edhe një herë se është e suksesshme, mbi të gjitha e drejtë dhe nuk dëmton askënd. Ajo është zbatimi i plotë dhe konkret i Ungjillit.

3b. Çfarë do të thotë për ty thënia se nuk mund të duhet Zoti që nuk shihet pa dashur tjetrin që e ke afër dhe shihet?

3b) Dashuria për Zotin kon-kretizohet, zbatohet, dëshmohet nëpërmjet dashurisë për Njeriun, të afërmin, që domethënë nëpërmjet Njeriut (si një lloj shkalje) Hyji na ngrit të vetja.

4. Në lidhje me seksualitetin: porrosia që parashtrihet nga Bibla është çliruese dhe madhështore. Kisha na kërkon të bëjmë edukim seksual.

4a. Çfarë mendoni a nevojitet edukim i një seksualiteti të harmonizuar të përgjegjshëm dhe që i jep gëzim zemrës?

4a) Ja pra, që na flet Kisha mbi seksualitetin: "në Orientimet Edukative mbi dashurinë njerëzore" të Kongregatës së Shenjtë për edukim katolik: "Seksualiteti është një komponent bazor dhe themelor i personit" (nr. 4.).

"Një aspekt themelor dhe bazor e një përgatitjeje të të rinjve për martesë konsiston në një vizion ekzakt të etikës së krishterë duke shikuar seksualitetin" (nr. 60).

"Duhet të insistohet mbi të gjitha në vlerat humane dhe të krishtera të seksualitetit për ti bërë që ti duan dhe për ti nxitur në dëshirë për t'u realizuar në jetën e tyre personale dhe në relacione me të tjerët" (nr. 88).

"Secili nga aspektet edukative seksuale frymëzohen nga feja duke qëndruar në Hirin dhe Forcën e mishëruar të Zotit. (nr. 110).

Seksualiteti i "shkëputur" nga tërësia e njeriut, personaliteti trup, psikë dhe shpirt, është robërim, humnerë, vetëshkatërrim, keqpërdorim...

4b. Çfarë sugjerimesh keni për këtë edukim?

4b) Nevojitet para se gjithash rikuperimi i dinjitetit njerëzor, sidomos i botës femërore, e cila në botën e sotme hedoniste është bërë "objekt seksual - gjësend", për të aftësuar rininë për dashuri, fjiutje dhe dhuruesi edhe nëpërmjet seksit. Sëpari jemi njerëz, persona, pastaj gjini, për përplotësim, e jo për ballafaqim dhe keqpërdorim.

Bota e shfrenuar me shumë sukses po e fut mentalitetin e saj në zemrat e njerëzve edhe këtu në Kosovë. Edhe ne duhet të bëjmë diçka, por nuk kam



tash për tash ide se çfarë duhet bërë. Kam provuar të flas privatisht me ndonjë prej vajzave që kanë kërkuar këshillë, por ato raste janë shumë të rralla. Rregullisht shumë vështirë flasin për këtë temë.

5. Bota jeton sot në një krizë të thellë ekonomike:

5a. Çfarë mendoni për thënien se njeriu ka vlerë për atë që është e jo për atë që ka?

5a) Pasuria thotë populli është "shërbëtor i mirë, por zotëri i keq", që dmtsh. se është mjet jetese, e jo qëllim, dhe nëse na sundon, atëherë na rrënon në tërësi.

5b. Çfarë mendoni për konceptin se para ekonomisë dhe mirëqenies duhet të jetë i vendosur në qendër genia njerëzore?

5b) Ekonomia e mirëqenies mendon vetëm në mirëqenien materiale, financiare, e jo në atë të njeriut si genie personale, familjare, shoqërore. Bota e sotme duket e robëruar nga para, pasuria, dhe si e tillë është pak njerëzore, edhe më pak e krishterë.

Keni përdorur nën a dhe b fjali shumë domethënëse dhe keni zgjuar në mua mendimin se këto fjali i takojnë më shumë atyre që kërkohen në punë. Kur një pronar i ndonjë firme të kërkojë punëtorë, atëherë kërkon që ata që do të lajmërohen në konkurs, të kenë kualitete të tilla dhe të ngjashme me këto.

6. Jezusi na kërkon të jemi të përsosur, sikurse Ati ynë që është në qiell:

6a. Cilat janë qëndrimet dhe sjelljet e një besimtari të rritur në fe?

6a) I hapur dhe në kërkim të vazhdueshëm ndaj Zotit dhe të afërmit, me qëndrime sa më të matura dhe në drejtpeshim mes materiale dhe shpirtërore.

6b. Si të jetohet me lutje, me falje, në angazhim dhe në politikë?

6b) Urata është dialog me Zotin; falja dhe kërkimi i faljes është zemra e krishterimit, kjo nuk mund të jetë vetëm qëndrim dhe veprim personal, familjar, por lypset të shprehet edhe në shoqëri.

Fatkeqësisht kemi shumë pak besimtarë që janë të zellsbëm në dëshmimin e fesë së tyre. Por, fatmirësisht njoh edhe të tillë që edhe në rrugë, edhe në punë, e sidomos në familjet të veta janë të gatshëm të dëshmojnë fenë e tyre me fjalë dhe me shembu-

llin e mirë të jetës së tyre.

7. Në Kishë është prijja e jetës bashkëshortore, jeta meshtarake dhe jeta e shugurimit.

7a. Si të promovohet thirrja e plotë dhe e veçantë?

7a) Në kontekstet plurireligjioze, ku shumica është e popullatës jo të krishterë, të promovosh një "kulturë të thirrjeve" kërkon këtë: të përcillen të rinjtë që të japin një kuptim të plotë jetës, në kohërencë me një vizion pozitiv dhe integral të personit dhe të shoqërisë; duhet t'u ndihmojmë të gjejnë sensin, kuptimin e Zotit dhe të shenjëve të pranisë së Zotit dhe të veprimtarisë në jetën e tij çdo ditë dhe çdo moment.

Duhet të zhvillohen të gjitha resurset të cilat ekzistojnë në religjionin e vet dhe duhet angazhuar të korrigjohen mungesat e tyre;

Duhet të zhvillohen dhe të thellësohen në përgjegjësinë e vetë sociale dhe politike në kohërencë dhe drejtësi më besimn e vet.

Sot duhet të punojmë në promovimin e tri thirrjeve: të krishterë, familjare (bashkëshortore) dhe të jetës së kushtuar meshtarake dhe rregulltare, sepse pa dy të parat nuk do të kemi as të tretën.

7b. Çka i përmblledh të gjitha thirrjet nga Zoti?

7b) Të gjithë jemi të ftuar dhe të dërguar në jetë dhe në dashuri. Duke e jetuar secilin në mënyrë të denjë thirrjen e vet dëshmon se ia vlen të jetohet në mënyrë të tillë, por njekohësisht duke e respektuar dhe nderuar edhe tjetrin në thirrjen e tij.

Përmbyllje:

Të jetuarit etik dhe moral të një besimtari është për atë diçka e pandashme me përvojën e besimit të tij.

Feja nxitë në besimtarin një përgjegjësi morale, dhe një mënyrë e të sjellit dhe të mbështetjes duke i dhënë motivim dhe konkludim përfundimtar.

Duhet t'i ndihmojmë të rinjve për të kërkuar dhe për ta gjetur duke e forcuar gjithmonë e më shumë me fe të fortë dhe me jetesë të jetuar në mënyrë religjioze, ku nga eksperiencia etike mund të plotësohet frymëzimi dhe ruajtja e energjive shpirtërore.

Viti i Shën Palit

Pyetjet për kuizin kateistik – Pjesa e tretë (111)

Fëmijë të dashur, të dashur katekistë!

Është planifikuar që para fundit të këtij viti kateistik të organizohet një kuiz ndërfaqullitar mbi mësimin e fesë. Në disa numra të revistës "Drita", në pjesën e veçantë për fëmijët, do t'i botojmë pyetjet për këtë kuiz. Në këtë numër gjendet pjesa e parë e pyetjeve. Nëse disa pyetje ju duken të vështira, lirisht mund t'i pyetni katekistët tuaj, që t'ju ndihmojnë për ta gjetur përgjigjen.

51. Trembëdhjetë letrat e Shën Palit janë shkruar reth viteve

- a) 50-60
- b) 150-260
- c) 1950-1960

52. Në letren e drejtuar Romakëve, Shën Pali e jep tërësinë e porosisë së krishterë, duke theksuar se <.....> është Shëlbuesi i mbarë njerëzimit e jo vetëm i hebrenjëve.

- a) Abrahami
- b) Jezu Krishti
- c) Moisiu.

53. Kisha e parë, e themeluar në Evropën e sotme, ishte në:

- a) Selanik
- b) Romë
- c) Filipi

54. Letra drejtuar Titit është shkruar kah fundi i jetës së Shën Palit dhe i drejtohet udhëheqësit të Kishës në:

- a) Bruksel
- b) Shkup
- c) Kretë

55. Letra drejtuar Filemonit – është shkruar si luftë indirekte kundër skllavërisë. Si quhet skllavi i njohur nga letra e Filemonit?

- a) Onesimi
- b) Barnaba
- c) Luka

56. Gjatë udhëtimit të parë misionar shën Pali, së bashku me Barnabën dhe pjesërisht edhe me shën Markun, si të dërguarit e Shpirtit Shenjt, kaluan nëpër:

- a) Qipro, Patmos, Pergë, Antioki
- b) Maqedoni, Listër, Frigji, Galaci, Misi dhe Troadë.
- c) Rodos, Kretë, Maltë dhe Romë

57. Në cilin qytet shën Pali pati një vegim të natës – kur një burrë maqedonas po qëndronte para tij dhe i bëri këtë lutje: "Kalo në Maqedoni e na ndihmo!" (Vap 16, 19-20)?

- a) në Troadë
- b) në Selanik
- c) në Romë

58. Në Filipi ndodhi edhe kthimi i një shitëse stofash të purpurt. Ajo ka qenë edhe mikpritëseja e parë e tyre dhe quhej:

- a) Monika
- b) Valentina
- c) Lidia

59. Në Korint Pali qëndroi afërsisht <.....>, duke punuar dhe shpallur Ungjillin (Vap 18, 1-3).

- a) tre vjet
- b) pesë muaj
- c) një vit e gjysmë.

60. Nga Korinti Pali shkoi në Efes, e më vonë në Antioki. Gjatë këtij udhëtimi ishte edhe në tokat <.....> të asaj kohe: (Vap 18, 22).

- a) gjermane
- b) ilire
- c) persiane

61. Koncili i parë i Kishës së hershme u mbajt në:

- a) Jerusalem
- b) Damask
- c) Korint

62. Vendimi kryesor i Koncilit të parë të apostujve për paganët ishte ky: "Përfundim, pra, Shpirti Shenjt dhe ne, që të mos ju ngarkojmë asnjë barrë tjetër përmbi ato që janë të nevojshme: të ruheni prej mishit të flijuar idhujve, prej gjakut, prej mishit të bagëtisë së furur ose të mbytur në ujë dhe nga <.....>". (Vap 15, 28-29)

- a) koprracia
- b) fëlligështia
- c) zilia

63. Në Lister me shën Palin u bashkua edhe një nxënës i njohur, të cilit shën Pali më vonë i ka shkruar dy letra. Cili (Vap, 16, 1)?

- a) Pjetri
- b) Luka
- c) Timoteu

64. Predikuesi i madh nga Aleksandria, që predikonte me sukses në Efes dhe në Akajë (Greqi), ishte: (Vap 18, 24-28)

- a) Apoloni
- b) Aleksandri
- c) Aristoteli

65. Si quhej argjendari që punonte tempuj të vegjël të Artemidës dhe organizoi kryengritje kundër shën Palit, sepse ky me sukses e largonte popullin nga idhujtaria, prej së cilës varej fitimi i argjendarit? (Vap 19, 23-27)

- a) Demosteni
- b) Demetri
- c) Denisi

66. Në cilin qytet u bë ajo kryengritje (rrëmujë)? (Vap 19, 23-27)

- a) Efes
- b) Selanik
- c) Durrës

67. Në Troadë Pali e ringjalli një djalë, që quhej: (Vap 20, 7-12)

- a) Enea
- b) Eulexi
- c) Eutihu

68. "Aspak mos u tremb! Si ke dëshmuar për mua në Jerusalem, po ashtu duhet të dëshmosh edhe në Romë." (Vap 23, 11) Këto fjalë shën Palit ia ka thanë:

- a) Engjëlli
- b) Zoti
- c) Anania

69. Në Jerusalem hebrenjtë kanë bërë komplot kundër Palit dhe "...u përбетuan se as s'do të hanë as nuk do të pinë pa e mbytur Palin". (Vap 23, 12-13) Sa veta u përбетuan?

- a) dyzet vetë
- b) njëzet vetë
- c) shtatë vetë

70. Para të cilit gjykatës shën Pali apeloj në Cezarin? (Vap 25, 1-12)

- a) para Faustit
- b) para Festit
- c) para Feliksit

71. "Ky njeri ka mundur të lirohet që më parë, po të mos kishte kërkuar të gjykohej para perandorit." (Vap 26, 32) Kush kujt i ka thënë këto fjalë?

- a) Festi Agripës
- b) Pilati Festit
- c) Agripa Festit

72. Te e cila ujdhesë shën Pali përjetoi anijethyerje, në të cilën nuk vdiq askush? (Vap 27, 39-28, 10)

- a) Maltë
- b) Qipro
- c) Kretë

73. Kujt ia drejtoi shën Pali këto fjalë të Isaisë profet: "Mirë u tha Shpirti Shenjt të parëve tuaj me gojë të Isaisë profet: 'Shko te ky popull e thuaj: me veshë tuaj do të dëgjoni, por gjë s'do të kup-toni; mirë do të shikoni, por gjë s'do të shihni. Guruar është zemra e këtij populli, veshët u janë shurdhuar, sytë u janë verbuar, që me sy të mos shohin, me veshë të mos dëgjojnë, që të mos kthehen e unë t'i shëroj'." (Vap 28, 23-28)

- a) egjiptianëve
- b) hebrenjëve, çifutëve
- c) italianëve

74. Plot <...> jetoi Pali në banesën që vetë e paguante. Aty i pranonte të gjithë ata që shkonin në takim me të. Predikonte Mbretërinë e Hyjit dhe mësonte me liri të plotë e pa kurrfarë pengese të vërtetën mbi Jezu Krishtin Zot. (Vap 28, 31)

- a) dy vjet
- b) tri vjet
- c) një vit



75. Sipas traditës së krishterë shën Pali pësoi martirizimin në Romë gjatë përndjekjeve të perandorit Neron, në vitin:

- a) 67 para Krishtit
- b) 67 pas Krishtit
- c) 100 pas Krishtit

76. Plotësoni fjalët:

Një predikues i madh i Ungjillit nuk ishte ndër 12 nxënës të Krishtit, por prapëseprapë quhej a _____. Është lindur në T _____. Emrin e kishte S _____. Në fillim salvonte Kishën. Në udhëtim për D _____ u takua me K _____ e gjallë dhe përjetoi kthimin. E mori edhe emrin e ri: P _____. Pasi gjatë vegimit mbeti i v _____, pas tri ditësh e shëroi A _____. U kushtua shpalljes së Ungjillit ndër p _____. Për këtë arsye bëri k _____ udhëtime të mëdha misionare. Udhëtimi e fundit e mbaroi në R _____, ku edhe vdiq si martir, dëshmor për fenë e Krishtit. Shkroi t _____ Letra, të cilat rregullisht lexojmë në M _____. Festa e tij festohet bashkë me shën P _____, më _____ qershor.


77. Këtu kemi një hartë të Mesdheut. Shkruani ku duhet emrat gjeografikë që vijnë: Roma, Iliriku, Selaniku, Filipet, Athina, Efesi, Tarsi, Damasku, Jerusalemi, Egjipti, Qiproja, Kreta, Malta, Sicilia, Tiri. (Mund t'ju ndihmojë edhe harta e Mesdheut në fillim të Biblës!)





TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

Faleminderit!



Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.



E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE
 Prishtinë • Shkurt 2009 • Viti XXVI • Nr. 2 (172) • Çmimi: Koronë 16, Eurosh 36, Zëriqë 3000, SHBA \$2.50

[illegible][illegible]

**Sauli përndjekës
i të krishterëve,
apo Pali apostull
i popujve**

**Më uratë dhe pendesë
dëshmojmë bukurinë
e thirrjes sonë
meshtarake**

